

Validimi për Shqipërinë:

Vlerësimi përfundimtar i progresit kundrejt zbatimit të Standardit EITI

Përmbajtja

Shkurtesa	3
Përmbledhje ekzekutive	4
1. Treguesit e efektshmërisë dhe qëndrueshmërisë	10
2. Rezultatet dhe ndikimi	14
3. Angazhimi i palëve të interesit	17
4. Transparenca	20
Tabloja e sektorit nxjerrës (Kërkesat 3.1, 6.3)	21
Mjedisi ligjor dhe regjimi fiskal (Kërkesat 2.1, 2.4, 6.4)	22
Licensat dhe të drejtat e pronësisë (Kërkesat 2.2, 2.3)	26
Pronarët Përfitues (Kërkesa 2.5)	28
Pjesëmarrja e shtetit (Kërkesat 2.6, 4.2, 4.5, 6.2)	31
Prodhimi dhe eksportet (Kërkesat 3.2, 3.3)	34
Mbledhja e të ardhurave (Kërkesat 4.1, 4.3, 4.4, 4.7, 4.8, 4.9)	36
Menaxhimi i të ardhurave (Kërkesat 5.1, 5.3)	43
Kontributi nënkombëtar (Kërkesat 4.6, 5.2, 6.1)	44
Sfondi	49
Burimet	50
Shtojca A: Shqyrtimi i Pronarëve Përfitues në qendrën Kombëtare të Biznesit	51
Shtojca B: Tabela e të ardhurave të Shqipërisë sipas Raportit të EITI-t 2017-2018	53
Publikimet e plota qeveritare dhe niveli i rakordimit	53
Pagesat ndaj NjQV-ve dhe niveli i rakordimit	54

Shkurtesa

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
Albeiti	EITI Shqipëri
AlbNet	Rrjeti Shqiptar - Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
ALL	Lek Shqiptar
PRV	Progres Raporti Vjetor
PP	Pronarët Përfitues
COVID-19	Sëmundja e Koronavirusit 2019
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
ADSh	Administrata Doganore Shqiptare
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
EITI	Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
AP	Administrator i Pavarur
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
ISIC	Klasifikimi Ndërkombëtar Industrial Standard për Veprimtaritë Ekonomike
KLSH	Kontrrolli i Lartë i Shtetit
NjQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSG	Grupi Ndër-institucional i Punës
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NIPT/NUIS	Numri Unik i Identifikimit të Subjektit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PEP	Person i Ekspozuar Politikisht
PPP	Partneritet Publik-Privat
KNP	Kontrata me Ndarje Prodhimi
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SECO	Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike
Sh.a.	Shoqëri Aksionare
Sh.p.k./Sh.a.k.	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
NSH	Ndërmarrje Shtetërore
TAP	Gazsjellësi Trans Adriatic
TeR	Termet e Referencës
TWh	Terravat orë
URL	Lokalizuesi Uniform i Burimeve/ hiperlinku online
USD	Dollar Amerikan

Përmbledhje ekzekutive

Projektraporti i Validimit paraqet gjetjet e Validimit të Sekretariatit Ndërkombëtar për Shqipërinë, i cili filloi më 1 tetor të 2021-shit. Projekt raporti u përmbyll më 18 nëntor 2021 me qëllim që të shqyrtohej nga grupi ndërinstitucional i punës (MSG). Pas komenteve të MSG-së, të paraqitura më 31 dhjetor 2021, raporti i Validimit u finalizua për t'u marrë në shqyrtim nga Bordi i EITI-t. Vlerësimi tregon se Shqipëria ka përbushur plotësisht 19 kërkesa, ka përbushur kryesisht tetë kërkesa dhe ka përbushur pjesërisht një kërkesë EITI. Shqipëria e ka ngritur procesin EITI duke u bazuar te publikimi periodik i informacionit, pjesëmarrja e gjerë e shoqërisë civile, si dhe duke e vënë theksin te çështje që kanë të bëjnë me tranzicionin energjetik dhe sektorin e hidroenergjetikës. Objektivat EITI janë në përputhje me prioritetet kombëtare. Palët e interesit e kanë përdorur platformën EITI për zhvillimin e debateve publike lidhur me reformimin e industrive nxjerrëse. Ndonëse Shqipëria nuk i ka përbushur ende plotësisht të gjitha kërkesat e standardit EITI, raporti nxjerr në pah një sërë fushash për zhvillim, të cilat duhen marrë parasysh nga palët shqiptare të interesit në forcimin e EITI-t si instrument kombëtar i qeverisjes së mirë.

Arritjet Kryesore

- EITI Shqipëri (Albeiti) ka filluar ristrukturimin e procesit të raportimit duke u mbështetur te publikimet rutinë të informacionit nga qeveritë dhe subjektet tregtare. Njëpërmjet të dhënave të hapura¹ dhe portaleve kadastrale, Albeiti ka pasur në dispozicion më tepër informacione, duke sjellë kështu një tablo mjaft të detajuar të veprimtarive nxjerrëse.
- Albeiti, njëpërmjet angazhimit intensiv të njësisve të qeverisjes vendore, shoqërisë civile dhe industrisë, ka tërhequr vëmendjen e publikut lidhur me transfertat nënkombëtare të rentës minerare kundrejt njësisve të qeverisjes vendore në Shqipëri. Nën drejtimin e shoqërisë civile dhe pavarësisht kufizimeve të COVID-19, janë zhvilluar debate mjaft të mira për transfertat nënkombëtare aktuale dhe aftësisë së këtyre transfertave për të financuar shërbimet publike në rajonet nxjerrëse.
- Nën kujdesin e Rrjetit Shqiptar - Nisma për Transparencë në Industrinë nxjerrëse (AlbNet), shoqëria civile janë angazhuar në debate dhe në procesin e depërtimit të komuniteti i gjerë, si për shembull njëpërmjet medias dhe institucioneve akademike. Për t'i përmirësuar më tej këto përpjekje dhe për të siguruar përbushjen e objektivave të planit të punës, nevojiten burime financiare më të qëndrueshme.

Fushat për zhvillim

- Albeiti e ka zgjeruar më tej angazhimin e shoqërisë civile në vend, gjë që vërtetohet nga aktivitetet e saj në transfertat nënkombëtare të lartpërmendura. Megjithatë, angazhimi i industrisë ka qenë nën pritshmëri. Disa prej shqetësimeve janë: mosraportimi nga një sërë shoqërisë, përdorimi i konfidencialitetit si barrierë për të anashkaluar kërkesat ligjore për raportimin, mospërcaktimi i mbulimit të përshtatshëm të industrisë dhe angazhimi i ulët në veprimtaritë e Albeiti-t. Pjesëmarrja aktive e shoqërive është thelbësore për të siguruar publikimin e duhur të informacionit në nivel projekti, me të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të besueshme financiare.

¹ Albeiti (2020), "Portali i Të Dhënave të Hapura". I disponueshëm në: <https://www.opendata-albeiti.org/>

² Albeiti (2021), "Portali i Kadastrës Minerare së Shqipërisë". I disponueshëm në: <https://miningcadastre.albeiti.org/>

- Sipas të dhënave që i janë vënë në dispozicion Albeiti-t, ekziston një mundësi për t'i shtuar përpjekjet lidhur me përdorimin e të dhënave nga portalet e qeverisë dhe subjekteve tregtare për analizë dhe debat. Disa fusha përfshijnë regjistrin e pronarëve përfitues, regjistrin e licencave dhe kontratave, si dhe procedurat për dhënien e licencave dhe kontratave.
- Së fundi, vlen për t'u lavdëruar puna e Albeiti-t me qeveritë rajonale dhe vendore për transfertat minerare dhe ndikimin mjedisor. Ka ende shumë hapësira për zgjerimin e këtij angazhimi edhe në fusha të tjera. Këtu përfshihet edhe domosdoshmëria që publiku t'i kuptojnë më mirë sistemet e menaxhimit financiar, sidomos përgjegjësitë fiskale të parashikuara në reformat e vitit 2014 për qeveritë rajonale dhe vendore. Një prej synimeve është edhe rishikimi i depozitimeve statutores nga ana e shoqërive pranë qeverisë, të cilat mund të përfshihen në raportimin e drejtpërdrejtë të Shqipërisë pranë EITI-t për pagesat nënkombëtare të shoqërive.

Progresi në zbatim

Validimi i EITI-t e vlerëson vendin nën shqyrtim sipas tre komponentëve “Rezultatet dhe ndikimet”, “Angazhimi i palëve të interesit” dhe “Transparenca”.

Rezultatet dhe ndikimi

Palët e interesit të EITI në Shqipëri kanë kontribuar në dialogun për politikën dhe në reformimin e çështjeve përkatëse në industrinë nxjerrëse. Gjatë periudhës së raportimit 2017-2018, Albeiti ka dhënë kontributin e saj për ligjet mbi publikimin e pronarëve përfitues, rregulloret mjedisore dhe rishikimet e vazhdueshme të legjislacionit për minierat.³ Palët e interesit në Shqipëri, sidomos shoqëria civile, i kanë përdorur dhe analizuar të dhënat e EITI-t për të ardhurat dhe transfertat nënkombëtare për të mbështetur angazhimin në politikë.⁴ Palët e interesit që janë konsultuar duket se vlerësojnë në mënyrë të veçantë zhvillimet e fundit të Kadastrës së Minierave dhe Portalin të Dhëna të Hapura. Këto platforma përmirësojnë aksesin në të dhënat e sektorit nxjerrës dhe atij hidroenergjetik. Përmes zgjerimit të mëtejshëm të publikimeve të të dhënave të hapura, Albeiti mund të ndikojë më tepër përmes referencave të kryqëzuara ose lidhjes së këtyre portaleve me sisteme të tjera qeveritare për publikimin e të dhënave. Ndonëse plani i punës shpreh qartësisht se objektivat e Albeiti-t janë në përputhje me prioritetet kombëtare, mund të bëhet më tepër lidhur me forcimin e lidhjes midis rishikimit vjetor të progresit të zbatimit nga ana e MSG-së dhe planit të punës së EITI-t, duke përdorur qasje të bazuara në rezultate për monitorimin dhe vlerësimin. Ky Validim ka identifikuar masat korrigjuese të Validimit të vitit 2019 që kanë mbetur ende të pazbatuara dhe në këtë drejtim MSG-ja mund të sigurojë ndjekjen e rekomandimeve të EITI-t në mënyrë më sistematike

Përfshirja e palëve të interesit

Qeveria dhe shoqëria civile kanë treguar angazhim të plotë, aktiv dhe efikas kundrejt zbatimit të EITI-t. Shumë përfaqësues qeveritarë nuk kanë ngurruar të shprehin mbështetjen e tyre për misionin e Albeiti-t. Financimi nga buxheti i shtetit (139,000 \$ në vitin 2020) mbuloi pagat dhe shpenzimet operacionale të Sekretariatit Kombëtar, por jo veprimtaritë zbatuese të EITI-t. Kjo është konfirmuar nga komentet e MSG-së në lidhje me draft-raportin e Validimit vetëm për

³Kuvendi i Shqipërisë(2021). “Ligji Nr. 65/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. .10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar. I disponueshëm në (vetëm në shqip):

[http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20210524182706ligji%20nr.%2065,%20dt.%2020.5.2021.p](http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20210524182706ligji%20nr.%2065,%20dt.%2020.5.2021.pdf)

⁴ AlbNet-EITI (2021). “Veprimtaritë“. Të disponueshme në: http://albneteiti.org/?page_id=800

aktivitetet e vitit 2020-2021. Përfaqësuesit qeveritarë i kanë diskutuar çështjet rreth zbatimit të EITI-t edhe me institucionet përkatëse (MIE, MFE, QKB, AKBN) përmes mbledhjeve dhe komunikimeve zyrtare. Anëtarët e MSG-së që vijnë nga shoqëria civile e kanë përshkallëzuar angazhimin, depërtimin dhe koordinimin me komunitetin e gjerë që prej vitit 2019, ndonëse ka prova që tregojnë se ka pasur kufizimeve të kapacitetit financiar që ka ndikuar në pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e EITI-t. Nga ana tjetër, përfaqësimi dhe angazhimi i industrive nxjerrëse në MSG duket të jetë dobësuar krahasuar me Validimin e fundit. Ndonëse emërimet e fundit në industri për plotësimin e pozicioneve të lira në MSG janë bërë në vitin 2021, angazhimi i industrive nxjerrëse duket se nuk ka përfshirë palë të tjera interesi përveç këtyre përfaqësuesve. Siç u përmend edhe në sfidat lidhur me pjesëmarrjen e shoqërive në raportimin e EITI-t, ka një objektiv të qartë për forcimin e angazhimit të EITI-t dhe përfshirjen e komunitetit të biznesit. Pandemia e Covid-19 ka minuar realizimin e planeve të MSG-së për të depërtuar fizikisht në mbarë vendin, gjë që ka sjellë uljen e angazhimit të palëve vendore të interesit. Megjithatë, Validimi ka vërejtur progres lidhur me depërtimin në terren gjatë konsultimeve, të cilat përfshinin kontaktet me palët e interesit nga rajone minerare që nuk janë angazhuar më parë me Albeiti-n.

Transparenca

Që prej Validimit të fundit, ka pasur publikime sistematike të informacionit lidhur me qeverisjen e industrive nxjerrëse në Shqipëri, përfshi këtu edhe sektorin hidroenergjetik. Sekretariati i Albeiti-t dhe MSG-ja kanë mbledhur vazhdimisht të dhëna nga burime të ndryshme qeveritare, të cilat i kanë analizuar më pas për të krijuar tablonë e plotë të operacioneve dhe veprimtarive nxjerrëse, dhe në konsolidimin e zbulimit të hapur të të dhënave përmes një portali të dhënash të sapopublikuar.⁵ Prapëseprapë, përmirësimi i mëtejshëm i analizimit të publikimeve sistematike të informacioneve nga ana e Albeiti-t mbetet ende objektiv. Qendra e Botimeve Zyrtare (QBZ), një portal qeveritar online, ofron akses në legjislacion dhe disa kontrata nxjerrëse nëpërmjet publikimit në Fletoren Zyrtare. Qendra Kombëtare e biznesit (QKB) ka edhe një regjistër publik tregtar, regjistra për disa lloje licensash, si dhe regjistrin e pronarëve përfitues të ngritur në vitin 2021. Albpetrol, një ndërmarrje shtetërore, i bën vazhdimisht publike pasqyrat e saj financiare të audituara, por edhe raporte të tjera si tenderët publikë dhe shitjet e naftës. Albeiti nuk i ka shqyrtuar ende raportet e Albgazit, ndërmarrje shtetërore për transportimin e gazit (NSh), dhe publikimet e Gazsjellësit Trans Adriatic (TAP) në Platformën Elektronike të të Dhënave⁶, por rëndësia e tyre është më të vërtetë e madhe pasi transportimi i gazit nga TAP ka filluar në vitin 2020. Transparenca për sa i përket pagesave të shoqërive dhe të ardhurave të qeverisë nga industritë nxjerrëse mbetet ende sfidë për Shqipërinë. Aktualisht, Shqipëria bën raportim të përgjithshëm të transfertave nënkombëtare, pasi ka disa kufizime ligjore që e pengojnë publikimin e plotë të të ardhurave qeveritare kombëtare dhe nënkombëtare nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari nxjerrëse. Vijnë sfidat lidhur me gjithanshmërinë dhe besueshmërinë e publikimeve financiare (shiko Kërkesat 4.1 dhe 4.9), si dhe në disagregimin e të dhënave të publikuara në nivel projekti për ato të ardhura që janë mbledhur për projekt.

⁵ Albeiti (2020), 'Open Data Portal'. <https://www.opendata-albeiti.org/>


⁶Gazsjellësi Trans Adriatic (2021), "TAP: Platforma Elektronike e të Dhënave". E disponueshme në: <https://edp.tap-ag.com/>

Figura 1 Modeli i pikëzimit: Përmbledhja e progresit në Validimin e Shqipërisë (2021)

Kërkesat EITI			Vlerësimi i sekretariatit	
Validimi për Shqipërinë(2021): vlerësimi për përmbushjen e Kërkesave EITI			Niveli i progresit	Pikët
Komponenti	Moduli	Kërkesat		
Rezultatet dhe ndikimi	Pikë shtesë	Treguesit e efektshmërisë dhe qëndrueshmërisë		2.5
	Rezultatet dhe ndikimi	Plani i punës (#1.5)	Përmbushur plotësisht	90
		Debati publik (#7.1)	Përmbushur plotësisht	90
		Akresi në të dhëna dhe të dhëna të hapura (#7.2)	Përmbushur plotësisht	90
		Rekomandimet e EITI-t (#7.3)	Përmbushur kryesisht	60
		Rezultatet dhe ndikimi (#7.4)	Përmbushur plotësisht	90
Angazhimi i palëve të interesit	Mbikëqyrja e pjesëmarrjes së palëve të shumta të interesit	Angazhimi i qeverisë (#1.1)	Përmbushur plotësisht	90
		Angazhimi i industrisë (#1.2)	Përmbushur kryesisht	60
		Angazhimi i shoqërisë civile (#1.3)	Përmbushur plotësisht	90
		Qeverisja e MSG-së (#1.4)	Përmbushur plotësisht	90
Transparenca	Tabloja e industrive nxjerrëse	Të dhënat e eksplorimit (#3.1)	Përmbushur plotësisht	90
		Kontributi ekonomik (#6.3)	Përmbushur plotësisht	90
	Kudri ligjor dhe fiskal	Kudri ligjor (#2.1)	Përmbushur plotësisht	90
		Kontratat (#2.4)	Përmbushur pjesërisht	30
		Ndikimi mjedisor (#6.4)	Pa vlerësuar	-
	Licensat	Dhënia e kontratave dhe licensave (#2.2)	Përmbushur kryesisht	75
		Regjistri i licensave (#2.3)	Përmbushur plotësisht	90
	Pronësia	Pronarët Përfitues (#2.5)	Përmbushur kryesisht	60
	Pjesëmarrja e shtetit	Pjesëmarrja e shtetit (#2.6)	Përmbushur plotësisht	90
		Të ardhurat në natyrë (#4.2)	Përmbushur plotësisht	90
		Transaksionet e NSh-së (#4.5)	Përmbushur plotësisht	90
		Shpenzimet kuazi fiskale të NSh-së (#6.2)	E pazbatueshme	-
	Prodhimi dhe	Të dhënat për prodhimin (#3.2)	Përmbushur	90

	eksportet		plotësisht	
		Të dhënat për eksportet (#3.3)	Përbushur plotësisht	90
	Mbledhja e të ardhurave	Gjithanshmëria (#4.1)	Përbushur kryesisht	60
		Kontratat për këmbimet tregtare (barter) (#4.3)	E pazbatueshme	-
		Të ardhurat nga transporti (#4.4)	E pazbatueshme	-
		Disagregimi (#4.7)	Përbushur kryesisht	60
		Përshtatshmëria kohore e të dhënave (#4.8)	Përbushur plotësisht	90
		Cilësia e të dhënave (#4.9)	Përbushur kryesisht	60
		Menaxhimi i të ardhurave	Shpërndarja e të ardhurave (#5.1)	Përbushur plotësisht
	Menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimet (#5.3)		Pa vlerësuar	-
	Kontributet nënkombëtare	Pagesat nënkombëtare direkte (#4.6)	Përbushur kryesisht	60
		Transferta të kushtëzuara (#5.2)	Përbushur plotësisht	90
		Investimet sociale dhe mjedisore (#6.1)	Përbushur kryesisht	60

Si pikëzohet progresi në Validimin e EITI-t



Pikët e përgjithshme (deri në 100) përfaqësojnë mesataren e pikëve të çdo komponenti.

Çdo kërkesë vlerësohet dhe pikëzohet sipas skemës më poshtë:

- **Tejkaluar (100 pikë):** Janë zbatuar të gjitha aspektet e kërkesës, përfshi aspektet “e pritshme”, “të inkurajuara” dhe “të rekomanduara” dhe objektivi i përgjithshëm i kërkesës është përmbushur nëpërmjet publikimeve sistematike të informacioneve në sistemet e qeverive dhe shoqërive.
- **Përmbushur plotësisht (90 pikë):** Objektivi i përgjithshëm i kërkesës është plotësuar dhe të gjitha aspektet e kërkesës janë trajtuar.
- **Përmbushur kryesisht (60 pikë):** Janë zbatuar aspektet më të rëndësishme të kërkesës dhe objektivi i përgjithshëm i kërkesës është përmbushur kryesisht.
- **Përmbushur pjesërisht (30 pikë):** Nuk janë zbatuar aspekte të rëndësishme të kërkesës dhe objektivi i përgjithshëm i kërkesës nuk është përmbushur.
- **Pa përmbushur (0 pikë):** Nuk është plotësuar asnjë ose thuhet asnjë aspekt i rëndësishëm i kërkesës dhe objektivi i përgjithshëm i kërkesës nuk është përmbushur aspak.
- **Vlerësimi i përmirësimeve/mospërmirësimeve nga Validimi i fundit (+15 pikë):** Vlerësimi i Kërkesës mbetet i njëjtë, por vlerësohet edhe progresi i shënuar kundrejt arritjes së objektivit të kërkesës që prej Validimit të fundit.
- **Pa vlerësuar:** Inkurajohen publikimet, por nuk kërkohen dhe nuk merren parasysh në pikëzim.
- **E pazbatueshme:** MSG-ja ka treguar se kërkesa është e pazbatueshme.

Kur provat nuk janë bindëse për një vlerësim të caktuar, kur palët e interesit ndajnë mendime të ndryshme rreth një çështjeje, ose grupi ndërinstitucional i punës nuk bie dakord me vlerësimin e Sekretariatit, situata në fjalë përshkruhet në vlerësim.

1. Treguesit e efektshmërisë dhe qëndrueshmërisë

Venditi jepet 0, 0.5 ose 1 pikë për secilin prej pesë treguesve. Këto pikë i shtohen pikëzimit mesatar të komponentit të rezultateve dhe ndikimit.

1.1 Rëndësia kombëtare e zbatimit të EITI-t

Treguesi shqyrton se deri në ç'shikallë i trajton zbatimi i EITI-t në Shqipëri sfidat dhe risqet e sektorit nxjerrës. Objektivat e zbatimit të EITI-t lidhen qartësisht me prioritetet kombëtare të Shqipërisë, përfshi axhendën e reformave ligjore që synojnë përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore dhe strategjinë qeveritare antikorrupsion. Shqipëria mbështetet në raportimin vjetor të EITI-t për të hedhur dritë mbi transaksionet në industrinë nxjerrëse. MSG-ja i ka shtrirë më tej përpjekjet për depërtim duke synuar zgjerimin e grupit të palëve të interesit në të gjithë vendin, duke iu referuar publikimeve të Albeiti-t. Për shembull, është ndërmarrë një projekt në bashkëpunim me OSBE-në për të ardhurat nga renta minerare, ku synohen autoritetet e qeverisjes vendore në komunitetet e prekura nga industrinë nxjerrëse⁷, gjë që i përgjigjet drejtpërdrejt objektivave të Shqipërisë të parashikuara në Planin e Punës 2018-2019 për t'i kuptuar më mirë transfertat nënkombëtare të rentave. Pagesat nënkombëtare dhe ndikimet janë çështje thelbësore për njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri dhe konsultimet konfirmuan se përpjekjet advokuese të EITI-t kanë pasur ndikim mjaft pozitiv në zhvillimin e dialogut midis palëve të interesit në nivel vendor/rajonar dhe palëve të interesit në nivel kombëtar rreth shpërndarjes së përfitimeve dhe ndikimit të industrive nxjerrëse. Palët e interesit vërejtën se tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia e COVID-19 vepruan si faktorë pengues në arritjen e rezultateve të planifikuara.

Albeiti i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i janë paraqitur duke shkuar përtej Kërkesave të EITI-t për trajtimin e sfidave kombëtare si tranzicioni energjetik. Hidroenergjetika renditet si burim energjie që zë vendin e dytë për nga rëndësia në Shqipëri, pas naftës, dhe si e tillë ka qenë në qendër të përpjekjeve të qeverisë gjatë tranzicionit në energji elektrike me sasi të ulëta karboni. Raporti më i fundit i EITI-t nxjerr në pah humbjet e mëdha në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, për të cilat qeveria shqiptare po punon që t'i trajtojë. Palët e konsultuara të interesit i bënë thirrje EITI-t që ta zhvillojë më tej këtë fushë pune nëpërmjet studimeve të mëtejshme për të vlerësuar teknologjitë e energjisë së rinovueshme, duke pasqyruar kështu përpjekjet kombëtare për zgjerimin e burimeve të energjisë së pastër, përfshi energjinë e erës dhe atë diellore. Në raportimet e ardhshme të EITI-t mund të bëhet një lloj përafrimi midis këtyre zhvillimeve dhe prioritetëve kombëtare për të krijuar një tablo më të qartë të tranzicionit energjetik në Shqipëri.

Duke marrë parasysh përafrimin e qartë midis veprimtarisë së EITI-t dhe çështjeve me rëndësi kombëtare në sektorin nxjerrës, Sekretariati propozon që pikëve totale të rezultateve dhe ndikimit për këtë tregues t'i shtohen **edhe 0.5 pikë të tjera**.

1.2 Publikimet sistematike të të dhënave për industrinë nxjerrëse

Ky tregues merr parasysh nivelin e publikimit sistematik të të dhënave në Shqipëri për sektorin nxjerrës nëpërmjet raportimit rutinë të qeverisë dhe subjekteve tregtare. Qeverisja digjitale është

⁷ Albeiti (2020), "Progres Raporti Vjetor" I disponueshëm në: <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/07/2020-eng-apr.pdf>

prioritet për Albeiti-n, siç pasqyrohet edhe në objektivat EITI. Aktualisht, 48% e të dhënave të kërkuara nga standardi EITI publikohet në mënyrë rutinë nga qeveria apo subjektet tregtare në Shqipëri, duke u bazuar në një vetëvlerësim nga Albeiti dhe të publikuara përmes platformës së publikimeve sistematike të EITI-t.⁸ Si pjesë e angazhimeve në kuadër të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur, qeveria po zbaton strategjinë për avancimin e shërbimeve të saj të e-qeverisjes dhe informacionit. Albeiti ka dhënë kontribut mjaft të konsiderueshëm në e-qeverisje përmes dy projekteve për të dhënat e hapura për qeverisjen e burimeve natyrore. Portali i të⁹ Dhënave të Hapura¹⁰ dhe Kadastra Minerare janë dëshmi e vlerës së shtuar të EITI-t si mbledhës të dhënash dhe ofrues i aksesit të përmirësuar të publikut në informacion. EITI në Shqipëri mbush boshllëqet në rastet kur qeveria nuk është në gjendje të publikojë sistematikisht. Megjithatë, këto përpjekje janë të pamjaftueshme për publikim sistematik teksa flasim, deri kur ministritë dhe agjencitë që zotërojnë të dhëna të mundësojnë akses të barasvlershëm në to. Staf i Sekretariatit Kombëtar të Albeiti-t ka përditësuar manualisht portalet me të dhënat e siguruar nga zotëruesit e të dhënave, gjë që kërkon mjaft burime. Pavarësisht kësaj, janë ndërmarrë disa reforma nëpërmjet rishikimit të legjislacionit për pronarët përfitues, ligjit për minierat dhe hapave referencë të disa veprimtarive të Albeiti-t në kuadër të planit të punës 2021-2022, të nevojshme për t'i zgjeruar më tej publikimet e EITI-t dhe për të përmirësuar publikimet sistematike të të dhënave të EITI-t përmes sistemeve rutinë të qeverisë.

Për të përmirësuar qëndrueshmërinë e publikimeve, Albeiti mund të punojë me agjencitë qeveritare për t'i lejuar sistemeve të informacionit të qeverisë ta integrojnë drejtpërdrejt këtë proces raportimi. Kur të dhënat hidhen online, burimet Albeiti mund t'i ridrejtohen veprimtarive që mund të kenë ndikim më të madh. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, portalet mund të zhvillohen më tej p.sh të zgjerohen për të përfshirë tekstin e plotë të kontratave lidhur me licensat minerare dhe hidrokarbure, të cilat janë publikuar si dokumente publike sipas palëve qeveritare të interesit që janë konsultuar. Një tjetër shembull ka të bëjë me legjislacionin, ku Albeiti duket se nuk ka përdorur publikimet rutinë të dokumenteve ligjore (të publikuara të paktën pjesërisht) përmes QKB-së. Në fakt, ndërkohë që QKB duket se publikon online dokumente legjislative të përditësuar, si për shembull aktet, rregullat dhe normat, Albeiti ende nuk duket se i ka rishikuar sistematikisht këto zbulime, për t'u siguruar që raportimi EITI të ndërtohet mbi zbulimet sistematike ekzistuese nga qeveria shqiptare.

Bazuar mbi progresin e shënuar kundrejt hapjes së portaleve online që promovojnë të dhënat e hapura dhe shërbejnë si themele për progresin e mëtejshëm kundrejt publikimit sistematik, Sekretariati propozon që pikëve totale të rezultateve dhe ndikimit për këtë tregues t'i shtohen edhe 0.5 pikë të tjera.

1.3 Mjedisi favorizues për pjesëmarrjen qytetare në qeverisjen e industrisë nxjerrëse

Treguesi merr parasysh nivelin e mjedisit favorizues së pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen e sektorit nxjerrës, përfshi edhe pjesëmarrjen e komuniteteve të prekura. Gjatë periudhës në shqyrtim, Albeiti i ka përshkallëzuar përpjekjet e tij për të depërtuar te shoqëria civile dhe te palët e tjera të interesit në komunitetet vendore dhe rajonale që preken nga industritë nxjerrëse. Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) ka ofruar mbështetje financiare

⁸ Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-t (2021), "Platforma e Publikimit Sistematik". E disponueshme në: <https://app.powerbi.com/view?r=eyJrIjojoiNjc2Y2ZmY2YtOWEzNSOONDdjLWJmNzYtMig3MMDYwM2NjODEwliwidCI6ImQwNDBmNjc3LTlxOTgtNGZkNCO5YjZLWJlYTYzNTJhNGRIMyIsImMiOj9>

⁹ Albeiti (2020), "Portali i të Dhënave të Hapura". <https://www.opendata-albeiti.org/>

¹⁰ Albeiti (2021), "Portali i Kadastrës Minerare së Shqipërisë". I disponueshëm në: <https://miningcadastre.albeiti.org/>

për një projekt që synon forcimin e shoqërisë civile në procesin Albeiti.¹¹ Në shkurt të 2020-s, bashkësia e shoqërisë civile drejtoi një sërë mbledhjesh me palët vendore të interesit për të prezantuar dhe shpjeguar përfitimet e angazhimit me EITI-n.¹² Përpjekjet për planifikimin e depërtimit të mëtejshëm në terren u penguan nga pandemia e COVID-19. Bashkësia e shoqërisë civile ka rinovuar anëtarësinë e saj në MSG. Në këtë grup janë përfshirë dy palë të reja interesi nga sektori mediatik dhe akademik që nuk kanë qenë më parë të përfshirë në EITI, por që kanë interes në industrinë nxjerrëse dhe në tranzicionin energjetik. Rinovimi i MSG-së është provë e pjesëmarrjes së gjerë qytetare në procesin e EITI-t. Depërtimi rajonal ka rritur ndërgjegjësimin rreth EITI-t, por nuk duket të ketë sjellë përfshirje më të gjerë gjeografike në zbatimin e EITI-t. Më tepër fokus te angazhimi i subjekteve tregtare në nivel rajonal do ta rriste më tej shkallën e raportimit të korporatave, pasi shumë shoqëri që nuk raportojnë janë ndërmarrje të vogla dhe vendore.

Palët e interesit nuk kanë asnjë shqetësim lidhur me angazhimin qytetar në industrinë nxjerrëse. Duke qenë se angazhimi qytetar nuk është konsideruar si shqetësim madhor nga palët e interesit në procesin EITI, nuk mund të vërehen përmirësime lidhur me angazhimin qytetar në procesin EITI. Raporti “Liria në Botë 2021”¹³ për Shqipërinë identifikoi kufizime të konsiderueshme të diskutimeve të lira dhe të hapura, përfshi edhe blogjet online dhe mediat sociale. Raporti vëren se OJF-të veprojnë në përgjithësi pa kurrfarë kufizimi, por kanë ndikim të limituar në politika për shkak të varësisë nga donatorët e huaj dhe sfidave që hasin në financim. Përfaqësuesit e shoqërisë civile e kanë vënë theksin te kufizimet financiare, si faktorë kufizues të pjesëmarrjes në procesin EITI. Palët e interesit u shprehën se Banka Botërore është donatori kryesor i veprimtarive të Albeiti-t dhe se rregullat në Termat e Referencës së MSG-së nuk i lejojnë përfaqësuesit e shoqërisë civile anëtarë të MSG-së që të përfitojnë drejtpërdrejt financiarisht nga veprimtaritë e planit të punës së EITI-t. Megjithatë, ky rregull nuk i pengon përfaqësuesit e shoqërisë civile që të japin kontributin e tyre në projektet e parashikuara në planin e punës. Albeiti mund të shtojë përpjekjet për mbledhje fondesh me qëllim diversifikimin e burimeve të financimit, gjë që mund të ndihmojë në zgjidhjen e problemit të kufizimeve financiare. Kështu, Sekretariati nuk mund të arrijë në përfundimin se EITI ka sjellë zgjerim të angazhimit qytetar në Shqipëri, por megjithatë, platforma EITI ka përmirësuar aksesin e shoqërisë civile dhe të publikut në çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen e sektorit nxjerrës.

Në kuadër të progresit kundrejt zgjerimit të depërtimit rajonal në terren dhe angazhimit të shoqërisë civile në debate publike rreth industrive nxjerrëse, Sekretariati propozon që pikëve totale të rezultateve dhe ndikimit për këtë tregues t'i shtohen edhe **0.5 pikë të tjera**.

1.4 Aksesueshmëria dhe përdorimi i të dhënave rreth industrisë nxjerrëse

Treguesi merr në konsideratë nivelin e aksesueshmërisë së të dhënave rreth sektorit nxjerrës dhe përdorimit të tyre për analizë, hulumtime dhe advokim. Albeiti ka dhënë kontribut të konsiderueshëm për përmirësimin e aksesueshmërisë në të dhënat e sektorit nxjerrës. Këtu mund të përmendim dy projekte që kanë zgjeruar më tej aksesin e publikut në të dhënat e hapura për qeverisjen e burimeve natyrore. Portali i të Dhënave të¹⁴ Hapura dhe Kadastra

¹¹Qendra Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim (2020), “Forcimi i Shoqërisë Civile në Procesin EITI të Shqipërisë”. I disponueshëm në: <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/09-eng-apr.pdf>

¹² Albeiti (2020), “Progres Raporti Vjetor” I disponueshëm në: <https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2021/07/2020-eng-apr.pdf>

¹³ Freedom House (2021). “Raporti i Lirisë në Botë për Shqipërinë 2021”. I disponueshëm në: <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2021>

¹⁴ Albeiti (2020), “Portali i të Dhënave të Hapura”. <https://www.opendata-albeiti.org/>

Minerare¹⁵ dëshmojnë se veprimtaritë e Albeiti-t kanë qenë vërtetë vlerë e shtuar në kuadër të përpjekjeve për të mbledhur të dhëna nga burime të ndryshme qeveritare dhe për t'i integruar ato në një burim të vetëm online. Të dhënat në këto portale mund të shkarkohen në format PDF, Excel dhe CSV. Palët e interesit të industrisë me të cilët jemi konsultuar shprehën se të dhënat e disponueshme në Kadastrën Minerare kanë qenë mjaft të dobishme për bashkësinë. Organizatat e shoqërisë civile janë përfshirë sidomos në përdorimin dhe analizimin e të dhënave të EITI-t për transfertat nënkombëtare. Ka prova që tregojnë se palët e interesit i kanë përdorur raportet dhe studimet hulumtuese të EITI-t për të advokuar rreth përfitimeve të komuniteteve rajonale dhe vendore nga të ardhurat e sektorit nxjerrës.¹⁶ Këtu përfshihen intervista dhe artikuj të botuar në kanalet mediatike shqiptare.¹⁷ Shoqëria civile e ka përdorur platformën EITI edhe për të lehtësuar dialogun me autoritetet vendore dhe kombëtare mbi të ardhurat nënkombëtare nga industrinë nxjerrëse.

Të gjitha këto janë mundësi të cilat duhen shfrytëzuar nga Albeiti për të bërë më shumë lidhur me ndërgjegjësimin dhe përdorimin e mjeteve të reja online të publikimit të informacioneve, përfshi portalin e të dhënave të hapura dhe kadastrën minerare. Portalet kanë përmirësuar aksesueshmërinë e publikut në informacione rreth licensave. Këto burime janë ende relativisht të reja, gjë që na ndihmon të shpjegojmë se përse ekipi i Validimit nuk gjeti prova që të tregonin se palët e interesit të qeverisë ose industrisë kanë përdorur ose analizuar të dhëna të vëna në dispozicion përmes këtyre portaleve. Pandemia e COVID-19 ka penguar përpjekjet e planifikuara të Albeiti-t për komunikim dhe depërtim në terren, përfshi edhe promovimin e Portalit të të Dhënave të Hapura dhe Kadastrës Minerare. Strategjia e Komunikimit dhe Depërtimit në Terren¹⁸ vërtet ka në fokus promovimin e Portalit të të Dhënave të Hapura dhe Kadastrës minerare, por nuk përcakton audiencat e shënjestruara që mund t'i përdorin këto mjete për debat publik, ose politikat dhe praktikrat që mund të ndryshohen si rezultat i përdorimit të të dhënave të EITI-t. Albeiti duhet ta ngushtojë më tej fokusin e strategjisë për sforcimin e ndikimit të zbatimit. Zbatimi i EITI-t mund të përmirësohet më tej duke u fokusuar më tepër te aspektet e inkurajuar nga Standardi i 2019-s, si raportimi për vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe pagesat sociale. Palët qeveritare të interesit të përfshira në këtë fushë pune duket se nuk janë të informuara rreth EITI-t dhe se si zbatimi tij mund të mbështesë axhendën për transparencë. Përfaqësuesit e industrisë kanë dhënë shembuj të kërkesave të autoriteteve rajonale për pagesa sociale të tilla si “taksa edukative“ që lidhet me zhvillimin e projektit. Albeiti mund të hetojë për këtë çështje në vijim të punës për ndikimin social të industrive nxjerrëse te komunitetet vendore.

Bazuar në progresin e Albeiti-t për përmirësimin e aksesueshmërisë së të dhënave të hapura, Sekretariati propozon që pikëve totale të rezultateve dhe ndikimit për këtë tregues t'i shtohen **edhe 0.5 pikë të tjera**.

1.5 Ndryshimet e nxitura nga EITI në politikrat dhe praktikrat e industrisë nxjerrëse

Treguesi merr në konsideratë se deri në ç'nivel ka mundur EITI të nxisë ndryshime në politikrat dhe praktikrat e sektorit nxjerrës. Plani i punës së Albeiti-t përfshin studime që mund të shërbejnë si bazë për politikrat lidhur me sektorin e naftës, gazit dhe minierat. Në vitin 2020, MSG-ja kontraktoi një konsulent për përgatitjen e një studimi për vlerësimin e ndikimit mjedisor të

¹⁵ Albeiti (2021), “Portali i Kadastrës Minerare së Shqipërisë“. I disponueshëm në: <https://miningcadastre.albeiti.org/>

¹⁶ AlbNet-EITI (2021). “Veprimtaritë“. Të disponueshme në: http://albneteiti.org/?page_id=800

¹⁷ AlbNet-EITI (2021). “Mediat“. Të disponueshme në: http://albneteiti.org/?page_id=650

¹⁸ Albeiti (2021). “Strategjia e Komunikimit dhe Depërtimit në Terren 2018 – 2022“ E disponueshme në:

¹⁸<https://www.albeiti.org/site/wp-content/uploads/2020/12-eng-apr.pdf>

industrive nxjerrëse në Shqipëri. Pavarësisht kushteve të vështira për shkak të pandemisë së COVID-19, konsulenti kreu një studim mjaft gjithëpërfshirës, me analiza të thelluara të vlerësimeve të ndikimit mjedisor. Studimi përfshiu shqyrtimin e legjislacionit shqiptar, përmes së cilit u realizua edhe analiza e boshllëqeve dhe u dhanë rekomandime për përmirësimin e rregullimeve mjedisore. Gjetjet sollën rishikimin e ligjit për minierat në vitin 2021, ku u pasqyruan Kërkesat EITI dhe u përfshinë rekomandime për ndikimin mjedisor.

Një tjetër studim i publikuar në shkurt të 2021-shit pati në qendër të tij ndikimin social të industrive nxjerrëse në komunitetet vendore dhe në punësim.¹⁹ Nisma u drejtua nga bashkësia e shoqërisë civile e angazhuar me Albeiti-n, gjë që lidhet me interesat e forta kombëtare të ndikimit ekonomik të të ardhurave nga sektori i minierave dhe hidrokarbureve, sidomos në rajonet ku këto industri janë më të përqendruara. Studimi plotësoi raportin vjetor të EITI-t duke ofruar informacione të mëtejshme kontekstuale. Gjetjet parashtuan se ligji për transfertat e rentës minerare kundrejt Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV) nuk ishte zbatuar plotësisht. Përfaqësuesit e shoqërisë civile ua kanë komunikuar gjetjet e studimit palëve rajonale të interesit për të rritur ndërgjegjësimin rreth ndikimeve sociale dhe çështjeve ekonomike. Kjo gjë ka ndihmuar edhe punën advokuese të Albeiti-t për pagesat nënkombëtare, për t'u siguruar se komunitetet vendore po i marrin të gjitha përfitimet financiare që u detyrohen veprimtaritë nxjerrëse në juridiksionet e tyre përkatëse. Albeiti po shikon mundësitë që gjetjet të nxisin më tej edhe debatin publik në Shqipëri lidhur me ndryshimet e mundshme të transfertave nënkombëtare, duke u fokusuar kryesisht te debati nëse 5% aktual i rentës minerare është i mjaftueshëm për shpërndarje të drejtë. Krahas angazhimit të komunitetit në pagesat nënkombëtare, konsultimet në kuadër të Validimit dhe shqyrtimi i dosjeve na dhanë shembuj të tjerë të kontributit të Albeiti-t në legjislacionin për pronarët përfitues dhe ndryshimet e ligjit për minierat, që duhet të përfshijë edhe ndikimin mjedisor (përmendur më lart).

Në kuadër të provave që raportimi dhe advokimi i Albeiti-t ka vënë në dispozicion për reformimin e legjislacionit për minierat lidhur me ndikimet mjedisore dhe praktikën e pagesave nënkombëtare, Sekretariati propozon që pikëve totale të rezultateve dhe ndikimit për këtë tregues t'i shtohen **edhe 0.5 pikë të tjera**.

2. Rezultatet dhe ndikimi

Ky komponent shqyrtonte kërkesat 7 dhe 1.5 të EITI-t, të cilat lidhen me progresin e prioriteteve kombëtare dhe debatin publik.

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI ose zbatimit të masave korrigjuese është i disponueshëm në formularët tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur shtojcës së këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Plani i punës (Kërkesa #1.5)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar që planifikimi vjetor i zbatimit të EITI-t të mbështesë edhe arritjen e prioriteteve	Përbushur plotësisht

¹⁹ Av. Haxhia dhe Hajdari (2021). "Studimi përfundimtar: Ndikimi Social i Industrive Nxjerrëse në Komunitetin Vendor dhe në Punësim". I disponueshëm në: http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2021/02/Social-impact-of-EI-in-Albania_Final-Draft_EN_EXE.pdf

	<p>kombëtare për industrinë nxjerrëse, duke parashikuar veprimtari realiste në bazë të konsultimeve me qeverinë, industrinë dhe shoqërinë e gjerë civile. Plani vjetor i punës së EITI-t është dokument thelbësor i llogaridhënies së MSG-së kundrejt bashkësisë së industrive nxjerrëse dhe publikut. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 1.5, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”.</p> <p>Plani i punës pasqyron objektivat strategjike të rëna dakord me MSG-në dhe të përafuara me prioritetet kombëtare e nevojat e palëve të interesit. Plani i punës është i aksesueshëm nga publiku përmes faqes së internetit të Albeiti-t. Plani i punës duhet ende të qartësojë lidhjen midis objektivave dhe mënyrës se si veprimtaritë ndihmojnë në arritjen e tyre. Krahas kësaj, palët e interesit të shoqërisë civile vërejtën kufizime financiare të cilat mund t'i pengojnë palët e interesit që të kryejnë plotësisht aktivitetet. Meqenëse plani i punës së Albeiti-t varet vetëm nga një partner zhvillimi, ka ende vend për të identifikuar burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit dhe asistencës teknike, për të siguruar zbatimin në kohë të planit të dakordësuar të punës.</p>	
Debati publik (Kërkesa #7.1)	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të mundësuar debat publik të mbështetur në prova rreth qeverisjes së industrisë nxjerrëse, përmes ofrimit të të dhënave përkatëse palëve të interesit, në mënyrë të tillë që të jenë të aksesueshme dhe të pasqyrojnë nevojat e palëve të interesit. Janë zbatuar aspektet më të rëndësishme të kërkesës dhe objektivi i përgjithshëm i kërkesës është përbushur kryesisht. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 7.1, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”.</p> <p>Publikimet dhe raportimet janë të aksesueshme për publikun në faqen e internetit të Albeiti-t. MSG-ja ka arritur të depërtojë më thellë në rajone dhe në shoqërinë e gjerë civile përfshi akademikët, opinionistët dhe gazetarët, ndonëse palët e interesit vërejtën se tërmeti i 2019-s dhe pandemia e COVID-19 kanë ndikuar negativisht në veprimtaritë e komunikimit dhe depërtimit në terren për shkak edhe të kufizimeve të lëvizjes dhe grumbullimeve. Albeiti ka bashkëpunuar me OSBE-në dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për ndikimin e industrive nxjerrëse të komunitetave vendore, duke rritur ndërgjegjësimin e palëve të interesit dhe mbështetur punën advokuese për pagesat nënkombëtare. Sërish Albeiti duhet të fokusohet më tepër te strategjia e komunikimit, ku duhet të përcaktojë audiencat që mund t'i përdorin këto mjete për debat publik.</p>	Përbushur plotësisht
Akresi në të dhëna dhe të dhëna të hapura (#7.2)	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të mundësuar përdorim dhe analizim më të gjerë të informacionit rreth industrive nxjerrëse, përmes publikimit të informacioneve në të dhëna të hapura dhe formate miqësore me përdoruesin. Objektivi i përgjithshëm i kërkesës është përbushur dhe të gjitha aspektet e kërkesës janë zbatuar.</p>	Përbushur plotësisht

	<p>Ka prova që tregojnë se MSG-ja ka bërë përpjekje për të përmirësuar aksesin në të dhëna të hapura. Albeiti ka ngritur Portalin e të Dhënave të Hapura dhe Kadastrën Minerare, nga ku të dhënat për naftën, gazin, minierat dhe hidrokarburet mund të shkarkohen në formate të ndryshme të hapura. Përmbledhja e të dhënave u përfundua pas publikimit të raporteve të EITI-t. Këto përpjekje, ndonëse janë shtuar kohët e fundit, mund të përmirësohen më tej duke siguruar lidhje në kohë reale me sistemet qeveritare.</p>	
<p>Rekomandimet nga zbatimi i EITI-t (Kërkesa #7.3)</p>	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për ta kthyer EITI-n në një proces të vazhdueshëm të të nxënit që kontribuon në politikëbërje, bazuar në marrjen parasysh të gjetjeve dhe rekomandimeve të procesit EITI nga MSG-ja dhe zbatimit të atyre rekomandimeve që shihen si prioritet. Niveli i progresit ka pësuar rënie që prej Validimit të fundit.</p> <p>Ka pasur progres në zbatimin e disa rekomandimeve të cilat burojnë nga raportet EITI. Përfaqësuesit e MSG-së kanë kontribuar në hartimin e kuadrit të ri ligjor për rentat. Nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Albeiti ka kontribuar edhe në hartimin e ligjit për pronarët përfitues dhe vendimit për ngritjen e regjistrimit të PP-ve. Kontributi kishte të bënte me ngritjen e një grupi ekspertësh, të cilët shqyrtuan nga pikëpamja ligjore transparencën në industrinë nxjerrëse, gjë që shërbeu si bazë për MIE-n në hartimin e ligjit 112/2020 "Për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues".</p> <p>Validimi i vitit 2019 theksoi se Albeiti e kishte ngritur me vonesë grupin e punës, për të cilin pati edhe një plan të kufizuar në plan kohor për të vepruar sipas mësimave të nxjerra, për të hetuar dhe trajtuar shkaqet e mospërputhjeve apo pikave të dobëta të procesit të EITI-t, si dhe për të marrë në konsideratë çdo rekomandim për përmirësim nga AP-ja. Ky Validim konfirmoi se procesi i MSG-së për të mësuar, rishikuar dhe vepruar në bazë të rekomandimeve përfshinte edhe një Grup Pune për Masat korrigjuese. Megjithatë, nga konsultimet dhe shqyrtimi i dokumentacionit nuk u gjet asnjë provë për diskutimet apo vendimet e këtij grupi që prej Validimit të 2019-s. Për më tepër, Albeiti nuk ka reaguar ndaj disa masave korrigjuese (shiko kërkesat 4.1, 4.6 dhe 4.9), të lidhura veçanërisht me sfidat e procesit të rakordimit. Të gjitha sa më lart vënë në pikëpyetje mekanizmat e MSG-së për zbatimin e vazhdueshëm të rekomandimeve dhe veprimeve korrigjuese. Sërish ka rëndësi të theksojmë se Raporti i EITI-t 2017-2018 i referohet progresit ose mungesës së progresit lidhur me trajtimin e gjetjeve dhe zbatimin e rekomandimeve të parashtruara në raportimet dhe validimet e EITI-t.</p>	<p>Përmbushur kryesisht</p>
<p>Rishikimi i rezultateve dhe ndikimit të zbatimit të EITI-t (Kërkesa #7.4)</p>	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar monitorim publik dhe vlerësim sistematik të zbatimit. Nuk ka prova që tregojnë se ka</p>	<p>Përmbushur plotësisht</p>

	<p>pasur regres lidhur me Kërkesën 7.4, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”.</p> <p>MSG-ja i vlerëson produktet, rezultatet dhe ndikimet nëpërmjet anketimeve, progres raporteve vjetore (PRV) dhe mbledhjeve me palët e interesit. Konsultimet treguan se pandemia e COVID-19 ka penguar angazhimin e përgjithshëm të EITI-t, përfshi këtu edhe mbledhjen e komenteve e sugjerimeve. PRV-ja e 2021-shit e vuri theksin te studimet e ndikimit social dhe mjedisor, përfshi edhe rekomandimet për monitorimin e të drejtave të grupeve të cenueshme dhe aspekteve gjinore në sektorin nxjerrës.</p>	
Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet		
<ul style="list-style-type: none"> • Për ta përmirësuar zbatimin e planeve të punës (Kërkesa 1.5), Shqipëria mund të përmirësojë përshkrimin e saj për mënyrën se si aktivitetet lidhen me objektivat më të gjera në përgjithësi, duke përfshirë mënyrën se si lidhen me nismat dhe synimet e qeverisë kundër korrupsionit. Gjithashtu Shqipëria mund të marrë në konsideratë edhe diversifikimin e burimeve të veta të financimit dhe asistencës teknike për të lehtësuar më tej pjesëmarrjen e plotë të grupeve të interesit në të gjitha veprimtaritë. Për ta përmirësuar më tej zbatimin, Shqipëria duhet të përdorë qasje me bazë rezultatet për realizimin e veprimtarive të parashikuara në planin e punës, për të pasur një bazë sa më të shëndoshë për monitorim dhe vlerësim. Së fundi, për të përmirësuar trajtimin e gjetjeve dhe zbatimin e rekomandimeve të parashtruara në raportimin dhe Validimin e EITI-t, Shqipëria mund të sigurojë përfshirjen e tyre në veprimtari specifike si pjesë e planeve të ardhshme të punës. • Për ta përmirësuar më tej aksesueshmërinë në të dhëna dhe të dhëna të hapura (Kërkesa 1.7), Shqipëria mund të fokusohet më tepër te saktësimi i fokusit të publikimit të komunikimeve për të identifikuar qartësisht audiencën e shënjestruar dhe kontributet e kësaj audience në debat publik. Faqja e internetit e Albeiti-t mund të përmirësohet më tej duke siguruar automatizimin e transferimit të informacionit midis portalit të të dhënave të hapura dhe kadastrës minerare dhe sistemeve qeveritare që mbështeten te të dhënat e lidhura me EITI-n. • Në përputhje me Kërkesën 7.3 për rekomandimet nga zbatimi i EITI-t, Shqipëria duhet të sigurohet që të ekzistojë një proces sa më të qartë dhe të dokumentuar që të garantojë rishikimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të parashtruara në raportimet dhe validimet e EITI-t. Për të përmirësuar më tej kapacitetin e palëve të interesit për përmbushjen e rekomandimeve, Shqipëria nxitet të sigurojë financim të mjaftueshëm nëpërmjet qeverisë për t'i përmbushur këto rekomandimet (shihni edhe rekomandimet në Kërkesën 1.1 të EITI-t për angazhimin e qeverisë) dhe të kërkojë mbështetje nga sekretariati EITI gjatë ngritjes së kapaciteteve ose proceseve teknike. • Për të përmirësuar më tej rishikimin vjetor të rezultateve dhe ndikimeve të EITI-t (Kërkesa 7.4), Shqipëria nxitet të depërtojë te bashkësitë më të mëdha të palëve të interesit, edhe përmes përdorimit të platformave të telekomunikacionit për zbutjen e kufizimeve të mundshme për shkak të pandemisë COVID-19. Për të përmirësuar përpjekjet për dokumentimin e ndikimeve të procesit EITI në Shqipëri, Shqipëria duhet të identifikojë objektivat për fushat prioritare dhe të ngrejë mekanizma të posaçëm për monitorimin e zhvillimit të vendit. 		

3. Angazhimi i palëve të interesit

Ky komponent vlerëson Kërkesat 1.1 dhe 1.4 të EITI-t, të cilat lidhen me mbikëqyrjen e pjesëmarrjes së bashkësive dhe palëve të shumta të interesit përgjatë procesit të EITI-t.

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI ose zbatimit të masave korrigjuese është i disponueshëm në formularët tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur shtojcës së këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Angazhimi i qeverisë (Kërkesa #1.1)	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar drejtim të plotë, aktiv dhe efikas qeveritar të zbatimit të EITI-t. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 1.1, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”. Shumë përfaqësues të qeverisë shprehën mbështetjen e tyre për misionin e Albeiti-t dhe konsultimet treguan qartësisht angazhimin e plotë, aktiv dhe efikas të qeverisë, me koordinim mjaft të fortë midis ministrive, nën drejtimin e Kryetarit të MSG-së dhe Zëvendës Ministrit të Infrastruktursë dhe Energjisë. Qeveria financon Sekretariatit Kombëtar, përfshi edhe pagat e stafit dhe shpenzimet operative, por nuk ofron mbështetje financiare për veprimtaritë e zbatimit. MSG ka konfirmuar këtë nëpërmjet komenteve të bëra në draft-raportin e Validimit, dhe ka sqaruar se qeveria nuk ka financuar disa aktivitete të caktuara për komunikim dhe shtrirje para pandemisë Covid-19.</p>	Përbushur plotësisht
Angazhimi i industrisë (Kërkesa #1.2)	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar angazhimin e plotë, aktiv dhe efikas të shoqërive nxjerrëse në procesin e EITI-t për sa i përket publikimeve të informacioneve, pjesëmarrjes në punën e grupit ndërinstitucional dhe krijimit të një mjedisi sa më favorizues për pjesëmarrje nga ana e qeverisë. Niveli i progresit ka rënë dhe ka prova që tregojnë se ka pasur regres që prej Validimit të fundit.</p> <p>Termet e Referencës së MSG-së përcaktojnë se bashkësia industriale nxjerrëse duhet të përfshijë “pesë përfaqësues të biznesit nga shoqëritë më të mëdha që operojnë në sektorin nxjerrës dhe hidroenergjetik, si dhe nga Shoqatat e Investitorëve në këtë sektor, ose nga Dhomat e Tregtisë me në fokus burimet natyrore”.²⁰ Në praktikë, gjatë periudhës 2019-2020 në MSG ka pasur pozicione të lira, gjë që tregon se industria nuk është angazhuar plotësisht dhe në mënyrë efikase (nuk ka të bëjë me pandeminë e COVID-19). Ndonëse pjesëmarrja e dy përfaqësuesve të industrisë, të emëruar që prej vitit 2019, është për t’u lavdëruar, emërimi i tre përfaqësuesve të tjerë ndodhi vetëm në shtator të këtij viti, pak para fillimit të Validimit. Pikat e dobëta të angazhimit të industrisë pasqyrohen edhe në praktikat e raportimit të shoqërive që prej Validimit të fundit. Në raportimin e EITI-t 2017-2018 kanë marrë pjesë një numër relativisht i vogël shoqëri materiale, ndonëse raportimi i shoqërive është një prej masave kryesore korrigjuese që lidhet me Kërkesën 4.1 që prej Validimit të fundit. Në mënyrë që Shqipëria ta përmirësojë pjesëmarrjen e shoqërive në raportimin e EITI-t dhe të shënojë progres lidhur me publikimet sistematike të informacioneve, kërkohet angazhim masiv i</p>	Përbushur kryesisht

²⁰ Albeiti (2015). “Termet e Referencës së MSG-së Neni 7 - Përbërja e MSG-së”. Të disponueshme në: <https://www.albeiti.org/site/en/regulation-of-msg/>

	<p>industrisë nxjerrëse dhe ndërgjegjësim rreth përfitimeve të publikimit të informacioneve nga ana e subjekteve tregtare. Paaftësia e bashkësisë për t'i angazhuar shoqëritë nxjerrëse joraportuese tregon se Shqipëria duhet të bëjë më tepër përpjekje që të sigurojë angazhimin e plotë, aktiv dhe efikas të shoqërive nxjerrëse me EITI-n, si për sa i përket publikimeve të informacioneve, ashtu edhe pjesëmarrjes në punën e MSG-së. Si pjesë e komenteve të MSG-së për draft-raportin e Validimit, u theksua se këto zbulime mund të theksojnë nevojën për rishikim dhe ndryshim të aspekteve ligjore për të garantuar zbulimin e të dhënave për publikun.</p>	
Angazhimi i shoqërisë civile (Kërkesa #1.3)	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar angazhimin e plotë, aktiv dhe efikas të shoqërisë civile në procesin EITI dhe krijimin e mjedisit favorizues për këtë angazhim. Niveli i progresit ka pësuar rritje që prej Validimit të fundit. Nuk ka prova për barriera ndaj pjesëmarrjes ose kontributit të shoqërisë civile në procesin EITI lidhur me lirinë e tubimit, shprehjes, veprimit ose aksesit në vendimmarrje publike. Si masë korrigjuese për Shqipërinë që prej Validimit të fundit, grupi i shoqërisë civile nxitet të zbatojë në praktikë të gjitha dispozitat e Kodit të Etikës, duke përfshirë edhe ato që lidhen me koordinimin e rregullt dhe marrjen në konsideratë të këndvështrimeve të ndryshme, si dhe të sigurohet depërtimi i duhur në terren të të gjitha OShC-ve që mund të jenë të interesuara për zbatimin e EITI. Provat dhe konsultimet me palët e interesit treguan se ky përmirësim ka ndodhur gjatë periudhës objekt vlerësimi. Procedura e emërimeve, e kodifikuar në dhjetor të 2018, është e disponueshme në faqen e internetit të Albeiti-t dhe është ndjekur si praktikë në raundin e fundit të emërimeve në vitin 2019. Bashkësia po drejtohet nga AlbNet, e cila po koordinon pjesën më të madhe të veprimtarive të informimit dhe depërtimit në terren, duke forcuar angazhimin, depërtimin dhe koordinimin. Palët e interesit kanë vërejtur se ka pasur kufizime financiare që mund ta kenë kufizuar pjesëmarrjen në të gjitha veprimtaritë e EITI-t, ndonëse kjo gjë nuk u ngrit si shqetësim për sa i përket aftësisë së anëtarëve të shoqërisë civile për t'u angazhuar me MSG-në. Midis palëve të interesit ka pasur konsensus se bashkësia ishte zgjeruar duke përfshirë në grup organizata të reja, ku ka pasur edhe koordinim më të rregullt. Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit sqaruan se parashikohen financime të ardhshme të Bankës Botërore për të shqyrtuar financimin e aktiviteteve të shoqërisë civile, të cilat mbeten për t'u vlerësuar në Validimet e ardhshme. Shoqëria civile i përdor dhe ia vë në dispozicion të dhënave EITI komuniteteve kërkimore dhe vendore. Theksi është vënë kryesisht te çështjet që kanë të bëjnë me transfertat nënkombëtare të rentës dhe ndikimin mjedisor e social, ndonëse ka ende vend për ta zgjeruar objektin dhe për të përfshirë fushat në fokus të AlbNet-it për vitet e ardhshme.</p>	Përmbushur plotësisht
Grupi Ndër-institucional i Punës (Kërkesa #1.4)	<p>Sekretariati Vlerëson se MSG-ja përfshin palë interesi që janë të rëndësishme për industrinë nxjerrëse në vend. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 1.4, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me "progres të kënaqshëm".</p> <p>MSG-ja vepron në përputhje me Termat e Referencës të miratuara në vitin 2016. Procesverbalet e mbledhjes publikohen në faqen zyrtare të Albeiti-t. Formatit dhe cilësia e këtyre procesverbaleve janë të</p>	Përmbushur plotësisht

	<p>ndryshme. Anëtarët kanë vepruar në përputhje me Kodin e Etikës dhe nuk ka prova që të tregojnë prani të konfliktit të interesit gjatë përmbushjes së detyrave. Palët e interesit u shprehën se procesi i MSG-së ishte efikas për sa i përket përfshirjes së të gjitha grupeve në vendimmarrje. Anëtarët e MSG-së duket se zotërojnë kapacitete të mjaftueshme për përmbushjen e detyrave të tyre. Megjithatë, përfaqësimi i industrisë në MSG nuk ka qenë i plotë për periudhën 2019-2021. Këto boshllëqe duket se pasqyrojnë pikat e dobëta të bashkësisë së industrisë dhe janë trajtuar për pasojë së bashku me angazhimin e bashkësisë me EITI-n (shihni Kërkesën 1.2). Njohuritë e anëtarëve të MSG-së rreth disa çështjeve të tilla si pagesat nënkombëtare ishin mjaft të mira, ndonëse po këta anëtarë mund t'i forcojnë më tej kapacitetet e tyre lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me licensimin dhe kërkesat e reja, përfshi këtu pronësinë përfituese dhe transparencën e kontratave. Mundësitë që ofron EITI për të nxënë nga kolegët në rajonin euroaziatik mund ta mbështesin më tej forcimin e kapaciteteve të tyre.</p>	
Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet		
<ul style="list-style-type: none"> • Për të forcuar zbatimin e EITI-t përmes angazhimit të plotë, aktiv dhe efikas (Kërkesa 1.1), qeveria mund të rishikojë burimet që i ka vënë në dispozicion EITI-t për të siguruar financim të qëndrueshëm për të gjitha aspektet e zbatimit, përfshi edhe veprimtaritë, publikimet dhe shpërndarjen e të dhënave lidhur me EITI-n. • Në përputhje me Kërkesën 1.2 të EITI-t, shoqëritë duhet të angazhohen plotësisht dhe në mënyrë aktive e efikase në procesin EITI, gjë që mund të arrihet duke e zgjeruar bashkësinë përtej MSG-së. Për më tepër, bashkësia e industrisë duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë me Termat e Referencës së MSG-së, më konkretisht me nenin 7 për përbërjen e MSG-së, më mënyrë që të përfshihen pesë përfaqësues biznesi. Ripërtëritja e kohëve të fundit të bashkësisë së industrisë është një hap përpara në këtë drejtim dhe shërben si mundësi që Albeiti të vendosë objektiva më të gjera lidhur me përmirësimin e raportimit të shoqërive dhe rritjen e ndërgjegjësimit rreth përfitimeve të publikimeve nga subjektet tregtare. Megjithatë, angazhimi i industrisë së gjerë ka rëndësi themelore për Shqipërinë në përmirësimin e gjithanshmërisë së raportimit, sidomos kur bëhet fjalë për barrierat ligjore që pengojnë publikimin e informacionit nga ana e qeverisë lidhur me të ardhurat. • Për ta forcuar më tej pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin EITI (Kërkesa 1.2), Albeiti mund të marrë në konsideratë diversifikimin e burimeve të financimit si rritja e financimit qeveritar për veprimtaritë etj. Kjo gjë mund të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të Albeiti-t. • Për të forcuar zbatimin lidhur me Kërkesën 1.4.b.i, Albeiti nxitet të ndërmarrë veprimtari për shtimin e njohurive në mënyrë që të forcojë kapacitetin e anëtarëve për të punuar me licensimin, pronësinë përfituese dhe transparencën e kontratave. Për shembull, për çdo temë të përmendur, Shqipëria mund (i) të përkufizojë se çfarë nënkupton me publikim të plotë të një license, pronar përfitues dhe kontratë transparente dhe (ii) të monitorojë nivelin e plotësisë së publikimeve qeveritare për licensat e shoqërive nxjerrëse, kontratat dhe pronarët. Kështu, Shqipëria do të ishte në pozita më të mira për të përcaktuar bazat, arritjet dhe objektivat lidhur me nivelin e transparencës në vend. 		

4. Transparenca

Ky komponent vlerëson Kërkesat 2 deri në 6 të EITI-t, të cilat janë kërkesa të Standardit EITI që lidhen me publikimin.

Tabloja e sektorit nxjerrës (Kërkesat 3.1, 6.3)

Tabloja e progresit në modul

Raportimi EITI në Shqipëri vijon të paraqesë tablonë e veprimtarive nxjerrëse në vend, përfshi veprimtaritë më të fundit, në zhvillim e sipër dhe të planifikuara të eksplorimit. Për më tepër, agjencitë qeveritare në Shqipëri bëjnë publikim sistematik të pjesshëm të këtij informacioni. Depozitimet e MSG-së për Validimin tregojnë ndër të tjera se aksesin në informacione të përditësuara, sipas të cilave jepen edhe licencat për eksplorim përmes portalit kadastral²¹, ndonëse nuk mund të izolohehen vetëm për veprimtaritë e kohëve të fundit lidhur me këto licenca, nuk paraqesin asnjë tablo të industrisë, ku do të mund të identifikoheshin edhe zhvillimet brenda një viti të caktuar fiskal. Shqyrtimi i publikimeve të kohëve të fundit nga ana e Sekretariatit tregojnë se kjo kërkesë vijon të jetë e përbushur plotësisht që prej Validimit të fundit.

Për sa i përket kontributit të sektorit nxjerrës në ekonomi, Instituti i Statistikave në Shqipëri (INSTAT) publikon sistematikisht të dhëna rreth kontributit të veprimtarisë minerare artizanale dhe të vogël, si dhe të sektorëve informalë në prodhimin e brendshëm bruto (PBB). Si publikime të tjera rutinë mund të përmendim edhe kontributin e sektorit nxjerrës në PBB, eksportet, punësimin dhe investimet. Megjithatë, të ardhurat e qeverisë nga sektori nxjerrës nuk duket se publikohen në mënyrë sistematike, ku të dhënat janë të disponueshme vetëm nëpërmjet raportimit EITI. Shqyrtimi i publikimeve të kohëve të fundit nga ana e Sekretariatit tregon se kjo kërkesë vijon të jetë e përbushur plotësisht që prej Validimit të fundit.

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI ose zbatimit të masave korrigjuese është i disponueshëm në formularët tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur shtojcës së këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Eksplorimi (Kërkesa #3.1)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar aksesin e publikut në tablonë e sektorit nxjerrës në vend dhe potencialit të tij, duke përfshirë veprimtaritë eksploruese të kohëve të fundit, aktuale dhe të planifikuara. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 3.1, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”.	Përbushur plotësisht
Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi (Kërkesa #6.3)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për ta ndihmuar publikun ta kuptojë më mirë kontributin e industrive nxjerrëse në ekonominë kombëtare dhe nivelin e varësisë nga burimet natyrore. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 6.3, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”. Albeiti ka siguruar të dhëna për kontributin e sektorit nxjerrës në PBB, të ardhurat e qeverisë dhe në eksporte. Për më tepër, Albeiti i ka disagreguar të dhënat e punësimit sipas gjinisë, si dhe	Përbushur plotësisht

²¹ EITI në Shqipëri (2021), “Kadastra Minerare e Albeiti-t”. E disponueshme në:

<https://miningcadastre.albeiti.org/>

	ka bërë edhe një përllogaritje të veprimtarive minerare artizanale e të vogla në vend dhe të kontributit të sektorit nxjerrës në investime.	
Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet		
<ul style="list-style-type: none"> Për ta përmirësuar zbatimin, Shqipëria duhet të sigurohet që EITI në Shqipëri të bashkëpunojë me INSTAT-in për të shqyrtuar publikimet sistematike të të dhënave rreth të ardhurave qeveritare nga kategoritë e veprimtarive ekonomike të përcaktuara në Sistemin e Kombeve të Bashkuara në Llogaritë Kombëtare, ose në Klasifikimin Ndërkombëtar Industrial Standard të Veprimtarive Ekonomike (ISIC). 		

Mjedisi ligjor dhe regjimi fiskal (Kërkesat 2.1, 2.4, 6.4)

Tabloja e progresit në modul

Shqyrtimi i publikimeve përkatëse nga ana e Sekretariatit tregon se objektivi i Shqipërisë për publikimin e informacionit rreth kuadrit ligjor dhe fiskal vijon të jetë plotësisht i përbushur që prej Validimit të fundit. Shqipëria vijon të japë shpjegimet e duhura rreth mjedisit ligjor për minierat, naftën dhe hidroenergjetikën në Shqipëri përmes raportimit të EITI-t. Megjithatë, pavarësisht referimit të publikimeve sistematike në depozitimet e MSG-së për Validimin, nuk ka prova të publikimeve sistematike të referencuara në raportimin EITI për zbulimin publik të ligjeve të zbatueshme, rregulloreve dhe roleve të agjencive të sektorit nxjerrës, apo të publikimeve sistematike të legjislacionit në nivel qendror apo nëpërmjet faqeve të internetit të agjencive qeveritare si AKBN²², MIE²³ ose Albpetrol.²⁴ Për më tepër, ndonëse është më se e qartë se ka pasur delegim të kompetencave rreth të ardhurave nga sektori nxjerrës në Shqipëri, nuk është ende e qartë në publikimet sistematike se cili legjislacion u jep të drejtë subjekteve nënkombëtare që të vendosin dhe të mbledhin të ardhura nënkombëtare (shihni Kërkesën 4.6). Megjithatë, Sekretariati i EITI-t ka konstatuar se shumica, për të mos thënë të gjitha aktet dhe vendimet janë lehtësisht të kërkueshme dhe të aksesueshme për publikun në QBZ.²⁵

Duket se në Shqipëri, asnjë kuadër ligjor apo praktikë ligjore nuk garanton publikim të gjithanshëm të përmbajtjes së licensave aktuale apo të ardhshme, ndonëse legjislacioni nuk duket ta ndalojë një gjë të tillë. Ka pasur disa pretendime lidhur me dispozitat e konfidencialitetit në kontratat me ndarje prodhimi (KNP) dhe koncesionet minerare në Raportin EITI 2017-2018 (shihni faqet 33,37,88), dhe politika mbizotëruese duket se nuk ndryshon për licensat dhe kontratat e dhëna përpara datës 1 janar 2021 krahasuar me ato të dhëna më pas. Qeveria shqiptare ka lidhur KNP të tjera pas datës 1 janar 2021, edhe pse publikimet sistematike tregojnë se janë dhënë ose transferuar disa licensa minerare (shihni formularët tip të dorëzuar nga Albeiti).

Ndonëse Albeiti mbledh dhe publikon listën e plotë të licensave, koncesioneve dhe kontratave të dhëna në Shqipëri (shihni Kërkesën 2.3 më poshtë për më tepër detaje), Albeiti nuk paraqet asnjë tablo bashkëlidhur këtyre listave për të treguar se cilat licensa janë bërë publike dhe nëse secila licensë është publikuar e plotë. Kështu, Sekretariati nuk ishte në gjendje të konstatonte

²²Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (2021), "Legjislacioni". I disponueshëm në: <http://www.akbn.gov.al/lesgjislacioni/>

²³Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2018) "Ligje". Të disponueshme në: <https://www.infrastruktura.gov.al/minerar-2/ligje/>

²⁴Albpetrol (2021), "Albpetrol: Faqja kryesore". E disponueshme në: <https://albpetrol.al/>

²⁵QBZ (2020), "Qendra e Botimeve Zyrtare" E disponueshme në: <https://qbz.gov.al>

nëse Shqipëria i ka publikuar licensat, koncesionet dhe kontratat e dhëna në vitin 2021 me tekst të plotë, përfshi këtu edhe shtojcat dhe shtesat.

Ekzistojnë disa shembuj që tregojnë se disa pjesë të licencave dhe kontratave janë të aksesueshme publikisht. Si shembull mund të marrin hedhjen në Fletoren Zyrtare të një KNP-je të lidhur midis Qeverisë Shqiptare dhe Eni Albania Ltd ²⁶e cila duket se është publikuar me tekst të plotë, si dhe licensat minerare të cilat janë publikuar në regjistrin e licensave të Qendrës së Biznesit ²⁷ Për pasojë, mbetet ende e paqartë nëse ka barriera ligjore që e pengojnë publikimin. Sërish mbetet e paqartë se çfarë nënkupton MSG-ja me “tekst të plotë të licensave, koncesioneve dhe kontratave, përfshi këtu shtojcat dhe shtesat e tyre”. Së fundi, ndonëse plani i punës së Albeiti-t për 2021-shin i referohet një studimi për analizimin e kuadrit ligjor për publikimin e licensave, ka ende pasiguri rreth afateve kohore të përfundimit të këtij studimi. Palët qeveritare të interesit duket se mendojnë se dokumentet e kontratave dhe licensave janë bërë tashmë publike (e cila është konstatuar përsëri përmes komenteve të MSG në draft-raportin e Validimit), ndonëse palët e interesit të bashkësive të tjera nuk janë shumë të sigurta nëse objektivi i kësaj kërkesë është përmbushur apo jo.

Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit identifikuan disa shoqëri të cilat morën leje për gjermime në vitin 2021, dhe ripohuan se në vitin 2021 nuk u dha asnjë PSA. Një rishikim i lejeve të dhëna për gjermime zbulon se certifikatat e licencave ishin në dispozicion për akses dhe analizim nga publiku, e cila duhet pranuar. MSG ofroi gjithashtu disa referenca të tjera për zbulimin e dokumenteve legjislative nga qeveria, kryesisht përmes faqeve të internetit të AKBN dhe MIE. Përveç kësaj, MSG dha referencë për faqen e internetit të Albpetrol, e cila përmban një listë të të gjitha kontratave për ndarjen e prodhimit (PSC) – edhe pse jo tekstet e vetë kontratave – duke iu referuar portalit të QKB për të gjetur tekstet e plota të të gjitha Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM-të). Prandaj, Albeiti nuk duket të ketë publikuar ende një listë të kombinuar të të gjitha PSC-ve dhe licencave për gjermime, duke treguar qartësisht se aty ku mund të aksesohen publikisht të gjitha VKM-të dhe dokumentet kontraktuale përkatëse, duke përfshirë shtojcat, ndryshimet dhe shtesat, aty ku zbatohet.

Kërkesa EITI lidhur me ndikimin mjedisor (Kërkesa 6.4) është një aspekt mjaft inkurajues i Standardit EITI dhe si e tillë nuk është pjesë e Validimit përveç se kur vendi e ka tejpermbushur kërkesën. Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka arritur, por ende nuk e ka tejkaluar objektivin për t’u ofruar palëve të interesit bazat për vlerësimin e përshtatshmërisë së kuadrit rregullator, përpjekjeve monitoruese për menaxhimin e ndikimit mjedisor të industrive nxjerrëse dhe përmbushjes së detyrimeve mjedisore nga ana e shoqërive nxjerrëse. Konsultimet me palët e interesit kanë zbuluar se ka disa portale elektronike që kanë publikuar raporte lidhur me Vlerësimet e Ndikimit Mjedisor (VNM) të realizuara përpara fillimit të veprimtarive nxjerrëse, ndonëse Albeiti duket se nuk ka bërë asnjë dokumentim lidhur me aksesueshmërinë publike të këtyre vlerësimeve.

²⁶ QBZ (2020), “Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 27, datë. 04/03/2020”. E disponueshme në: <https://qbz.gov.al/share/005OrwNwTQSBVBy2df4KdQ>

²⁷ QKB (2021), Lista e licensave të lëshuara nga QKB-ja”. E disponueshme në: <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/>

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave të EITI-t ose masave korrigjuese është mundësuar falë modeleve tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur në shtojcën e këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Mjedisi ligjor dhe regjimi fiskal (Kërkesa #2.1)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë që publiku t'i kuptojë më mirë të gjitha aspektet e kuadrit rregullator për industrinë nxjerrëse, përfshi kuadrin ligjor, regjimin fiskal, rolet e subjekteve qeveritare dhe reformat. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 2.1, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me "progres të kënaqshëm". Është qartësuar niveli i delegimit fiskal, ndonëse nuk është dokumentuar se si/ku NjQV-ve u është dhënë autoriteti për vendosjen e taksave dhe tarifave (kjo çështje theksohet në Kërkesën EITI 4.6). Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit theksuan legjislacionin përkatës, edhe pse MSG mund të sigurohej gjithashtu që ta përfshinte këtë në raportimin EITI. Krahas kësaj, Albeiti mund të saktësojë se ku janë publikuar sistematikisht ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, të identifikuar në raportimin EITI.	Përbushur plotësisht
Kontratat (Kërkesa #2.4)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur pjesërisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar aksesueshmëri publike në të gjitha licensat dhe kontratat e veprimtarive nxjerrëse. Aspekte mjaft të rëndësishme të kësaj kërkesë kanë mbetur ende pa trajtuar: Është ende e paqartë është publikuar apo jo teksti i plotë i të gjitha licensave, koncesioneve dhe kontratave të dhëna në vitin 2021. Aktualisht nuk ka ende një politikë që qartë qeveritare, edhe pse MSG-ja duket se e konsideron kuadrin ligjor dhe praktikën të favorshme për zbulimin e plotë të përmbajtjes së licensave dhe kontratave të ardhshme ose aktuale. Duket se praktika e përgjithshme që ndiqet është kjo: në Fletoren Zyrtare publikohen (të paktën pjesërisht) kontratat me ndarje prodhimi (KNP) dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) publikohen licensat minerare. Albeiti duket se ka hartuar listën e plotë të licensave që ekzistojnë në Shqipëri, por nuk tregon se cilat dokumente përbëjnë publikim të plotë të shtojcave ose shtesave të një koncesioni, kontrate apo license. Teksa palët shqiptare të interesit e konfirmojnë qëllimin e tyre për të publikuar përmbajtjen e koncesioneve, kontratave dhe licensave të dhëna ose të ndryshuara pas datës 1 janar 2021, mbetet ende e paqartë (i) se çfarë nënkupton MSG-ja me "tekst të plotë të licensave, koncesioneve dhe kontratave, përfshi shtojcat dhe shtesat e tyre" dhe (ii) nëse Albeiti mban një listë të licensave, kontratave ose koncesioneve që janë aktualisht në dispozicion të publikut. Ndërkohë që komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit kanë identifikuar disa kompani që kanë marrë leje për gjermim në vitin 2021, komentet nuk duken se adresonin dy çështjet e theksuara më sipër. Ndërkohë që Albeiti duket se mban një listë të licensave dhe kontratave aktive, në to nuk përfshihen referenca për faktin nëse mund këto dokumente mund të aksesohen dhe (saktësisht) ku mund të aksesohen. Si përfundim, plani i punës së Albeiti-t për 2021-shin i referohet një studimi për analizimin e kuadrit	Përbushur pjesërisht

	ligjor për publikimin e licensave dhe kontratave, por ka ende pasiguri rreth realizimi të këtij studimi. Palët e interesit të bashkësive të ndryshme duket se nuk ndajnë të njëjtin mendim lidhur me faktin nëse objektivi i kësaj kërkesë është përmbushur apo jo.	
Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (Kërkesa #6.4)	Kërkesa 6.4 është një aspekt mjaft inkurajues i Standardit EITI dhe si e tillë nuk është pjesë e Validimit përveç se kur ka prova që vendi e ka tejpermbushur kërkesën. Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka arritur objektivin për t'u ofruar palëve të interesit bazat për vlerësimin e përshtatshmërisë së kuadrit rregullator, përpjekjeve monitoruese për menaxhimin e ndikimit mjedisor të industrive nxjerrëse dhe përmbushjes së detyrimeve mjedisore nga ana e shoqërive nxjerrëse. Raporti qartëson rolin e agjencive të ndryshme qeveritare, përfshi kërkesat për titullarët e të drejtave të veprimtarisë nxjerrëse dhe identifikimin e AKBN-së si agjenci që vlerëson përputhshmërinë e shoqërive me termat mjedisore të licensave dhe koncesioneve. Megjithatë, raporti i EITI-t nuk i referohet në mënyrë precize dokumenteve publike ku mund të gjenden për shembull Vlerësimet e Ndikimit Mjedisor. MSG-ja ka ofruar informacion për një sërë raportesh si për shembull për Planin Vjetor Kombëtar të Monitorimit Mjedisor dhe kërkesat e veçanta të Rehabilitimit mjedisor që duhet të plotësojnë shoqëritë. Albeiti duket se ka dhënë kontributin e tij për ndryshimet ligjore duke e vënë theksin te aspektet mjedisore.	Pa vlerësuar
Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet		
<ul style="list-style-type: none"> Për ta përmirësuar zbatimin e Kërkesës 2.1 të EITI, Shqipëria mund të ofrojë informacion të saktë se ku janë publikuar sistematikisht ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, të identifikuar në raportimin e EITI-t. Kjo mund të përfshijë edhe vlerësimin vjetor nga ana e MSG-së se cilat agjenci qeveritare i përditësojnë rregullisht faqet e tyre të internetit dhe portalet për të ofruar shpjegime ose përmbledhje rreth ndryshimeve më të fundit të legjislacionit. Në përputhje me Kërkesën EITI 2.4, Shqipëria mund të sigurojë publikimin e çdo kontrate, certificate license ose marrëveshjeje tjetër ligjore pas datës 1 janar 2021 që i japin të drejtë shoqërive të nxjerrin naftë, gaz ose minerare. Ndonëse Shqipëria publikon sistematikisht disa kontrata, koncesione ose licensa, mbetet ende e paqartë (i) se çfarë nënkupton MSG-ja me “tekst të plotë të licensave, koncesioneve dhe kontratave, përfshi shtojcat dhe shtesat e tyre” dhe (ii) nëse Albeiti mban një listë të licensave, kontratave ose koncesioneve që janë zbuluar plotësisht deri më tani (duke përfshirë të gjitha shtojcat, ndryshimet dhe shtesat), me referenca specifike për çdo dokument të publikuar. Për të pasur një tablo sa më të plotë rreth licensave dhe kontratave që janë të aksesueshme publikisht, Albeiti mund të marrë në konsideratë paraqitjen e kësaj tabloje përmes publikimeve të veta sistematike të regjistrave në faqen e internetit dhe në përputhje me rekomandimet e ngjashme për zbatimin e monitorimit të EITI-t sipas Kërkesës 7.3. Për ta përmirësuar aksesin e publikut në vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe për të siguruar mirinformimin e komuniteteve vendore rreth detyrimeve dhe risqeve të veprimtarive të shoqërive nxjerrëse në Shqipëri, MSG-ja mund të shikojë mundësitë për bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të eksploruar potencialet për hapjen e portalit elektronik lidhur me Vlerësimet e Ndikimit Mjedisor për publikim. 		

Licensat dhe të drejtat e pronësisë (Kërkesat 2.2, 2.3)

Tabloja e progresit në modul

Në përgjithësi, gjatë vitit 2018, i cili ishte objekt vlerësimi, janë dhënë 16 leje të reja minerare dhe janë transferuar pesë licensa minerare. Gjatë vitit 2018 objekt vlerësimi nuk është dhënë apo transferuar asnjë licensë apo e drejtë në sektorin e naftës dhe gazit. Albeiti ka shënuar mjaft progres në trajtimin e masave korigjuese lidhur me të drejtat e licensës dhe pronësisë.

Lidhur me procedurat e dhënies së licensës dhe kontratës (Kërkesa 2.2), Albeiti ka trajtuar disa aspekte të masave korigjuese që prej Validimit të fundit. Procesi i transferimit ose dhënies së licensave në sektorin minerar, përfshi edhe kriteret e veçanta teknike dhe financiare, është i përshkruar si duhet. Kur licensat janë dhënë përmes procedurës konkurruese gjatë vitit objekt i vlerësimit të sektorit minerar, qeveria ka publikuar informacion edhe për listën e aplikantëve (përfshi edhe aplikantët jo fitues) online. Megjithatë, një masë mjaft e rëndësishme korigjuese ka mbetur ende e pazbatuar që prej Validimit të fundit. Nuk ka prova që të tregojnë se Albeiti ka bërë një vlerësim të devijimeve përmbajtjesore në dhënien ose transferimin e licensave gjatë vitit objekt vlerësimi (2018). Ndonëse përshkruajnë të gjitha procedurat statutores për dhënien ose transferimin e licensave, Raporti i EITI-t 2017-2018 dhe publikimet e lidhura me të nuk analizojnë nëse këto procedura janë ndjekur në praktikë gjatë vitit objekt vlerësimi. Konsultimet me palët e interesit zbuluan se shumica e palëve të interesit besonin se ligjet aktuale nënkuptonin zbatimin praktik të tyre, por MSG-ja nuk ka bërë asnjë punë shtesë për ta vërtetuar këtë gjë. Palët e interesit nuk ishin të qartë nëse ishte përmbushur objektivi i kësaj kërkesë, por pranuan faktin se nuk ishin bërë kontrole për devijime, pavarësisht shqetësimeve të publikut lidhur me ²⁸dhënien e licensave pas vitit fiskal objekt vlerësimi. Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit dhanë referenca për transferimin e lejeve për gërmime konfirmuan se MSG nuk ka identifikuar asnjë devijim material nga kuadri i zbatueshëm ose rregullator. Megjithatë, MSG nuk dha referenca për dokumentacionin e aksesueshëm nga publiku për mënyrën se si MSG ka vlerësuar devijimet e mundshme nga proceset e zbatueshme, as konkluzione në lidhje me këtë vlerësim. Kjo është diçka problematike, duke pasur parasysh konkluzionin e Raportit EITI se “nuk ishte në gjendje të kryente dhe vlerësonte praktikën e lejeve dhe transferimeve në periudhën që shqyrtohet” (faqja 89 e Raportit EITI 2017-2018).

Për sa i përket Kërkesës 2.3, Albeiti ka shënuar progres të konsiderueshëm gjatë kalimit në publikime direkte dhe të sistematizuara të të dhënave sipas Kërkesës 2.3, përmes regjistrave online për gazin dhe naftën, duke siguruar publikime më të sakta në kohë se Raporti Vjetor i EITI-t. Regjistrat janë përditësuar çdo gjashtë muaj. Të dhënat e regjistrit të licensave të disponueshme në fillim të Validimit mbulonin vitin 2020 për sektorin e naftës dhe gazit²⁹ dhe përfshinë edhe sektorin minerar deri në korrik të 2021-shit.³⁰ Të gjitha palët e konsultuara të interesit nxorën në pah kontributin e Albeitit-t në përmirësimin e aksesueshmërisë publike të informacionit të gjithanshëm për të drejtat pronësore lidhur me depozitat dhe projektet nxjerrëse.

²⁸ La Via Libera (2021), “Eni po kërkon naftë në Shqipëri, por nuk ka asnjë vlerësim të ndikimit mjedisor”. I disponueshëm në: <https://lavialibera.it/it-schede-661-eni-albania-oil-exploration-environmental-damages#email>

²⁹ Albania EITI (n.d.), ‘Regjistri i Licensave Në Sektorin Hidrokarbur [Register of Licenses in the Hydrocarbon Sector]’. I disponueshëm në: <https://www.albeiti.org/site/regjistri-i-kompanive-koncensionare/>

³⁰ Albania EITI (n.d.), ‘Regjistri i Licensave Në Sektorin Minerar [Register of Licenses in the Mining Sector]’. I disponueshëm në: <https://www.albeiti.org/site/regjistri-minerar/>

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave të EITI-t ose masave korrigjuese është mundësuar falë modeleve tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur në shtojcën e këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Dhënia e kontratave dhe licensave (Kërkesa #2.2)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për t'i ofruar publikut tablonë rreth dhënies dhe transferimeve të licensave të naftës, gazit dhe minierave, procedurave statutore për dhënien dhe transferimin e licensave dhe nëse këto praktika janë ndjekur në praktikë. Është shënuar progres sidomos kundrejt masës korrigjuese nga Validimi i fundit lidhur me përshkrimin e procesit të dhënies ose transferimit të licensave në sektorin minerar, përfshi edhe kriteret e veçanta teknike dhe financiare. Kur licensat janë dhënë përmes procedurës konkurruese gjatë vitit objekt i vlerësimit të sektorit minerar, qeveria ka publikuar informacion edhe për listën e aplikantëve (përfshi edhe aplikantët jo fitues) në përputhje me Kërkesën 2.2 (c). Kjo gjë është bërë përtej barrierave të perceptuara ligjore për publikimin e ofertuesve jofitues, sipas dokumentimeve të AP-së. Megjithatë, Albeiti nuk ka dhënë ende dokumentacion për mënyrën se si MSG ka vlerësuar nëse ka devijime të parëndësishme në dhënien ose transferimin e licensave në sektorin minerar, në përputhje me Kërkesën 2.2 (a) (iv), sidomos duke marrë parasysh se Raporti EITI “nuk ishte në gjendje të bënte një vlerësim”. Nuk është bërë asnjë dhënie apo transferim license në sektorin e gazit dhe naftës gjatë vitit objekt vlerësimi, gjë e cila është konfirmuar gjithashtu përmes komenteve të MSG për draft-raportin e Validimit.	Përbushur kryesisht (me përmirësime që prej Validimit të fundit)
Regjistri i licensave (Kërkesa #2.3)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar aksesueshmërinë publike të informacionit të gjithanshëm rreth të drejtave pronësore lidhur me depozitat dhe projektet nxjerrëse. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 2.3, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”. Albeiti mban kadastrën minerare, regjistrin e licensave minerare që e përditëson dy herë në vit dhe regjistrin e licensave hidrokarbure. Shqipëria i ka publikuar online dhe sistematikisht të gjitha të dhënat e përmendura në Kërkesën 2.3, përveç datave të aplikimeve për licensë për licensat e minerareve, naftës dhe gazit, ndonëse në Validimin e Dytë për Shqipërinë, Bordi i EITI-t shprehu këndvështrimin se mungesa e datave të aksesueshme publikisht lidhur me aplikimet ishte çështje dytësore që nuk ndikonte në progresin e Shqipërisë kundrejt arritjes së objektivit të përgjithshëm të transparencës së informacioneve rreth licensës. Ky këndvështrim mbështetet edhe nga Validimi i fundit. Duhet vërejtur se ndonëse nuk bëhen të ditura shprehimisht, datat e skadimit të licensave minerare dhe hidrokarbure mund të nënkuptohen nga data e dhënies dhe kohëzgjatja e licensave që janë publikuar në regjistrin e licensave online për sektorin minerar dhe hidrokarbur. Në komentet e saj në draft-raportin e Validimit, MSG e ka konfirmuar këtë mundësi dhe synimin e Albeiti për të siguruar këto të dhëna në të ardhmen.	Përbushur plotësisht

Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet

- Në përputhje me Kërkesën 2.2.a.iv të EITI-t, Shqipëria duhet të dokumentojë vlerësimin nëse ka pasur devijime përmbajtjesore nga procedurat statutorë lidhur me dhënien ose transferimin e licensave të naftës, gazit dhe minierave. Për këtë, MSG-ja e Albetitit duhet të shqyrtojë procesin e licensimit për naftën, gazin dhe minierat, duke përzgjedhur ose disa (ose bazuar te materialiteti i shoqërisë, ose te risku i perceptuar nga Albeiti), ose të gjitha licensat e dhëna ose të transferuara për analizë të mëtijshme nëse janë ndjekur në praktikë të gjitha procedurat ligjore, duke shpjeguar devijimet dhe duke identifikuar nëse janë përmbajtjesore apo jo (të parëndësishme). Për të siguruar respektimin e vazhdueshëm të Kërkesave EITI, Albeiti duhet të qartësojë nëse ka barrierat ligjore që pengojnë publikimin e ofertuesve jofitues dhe duhet të sigurojë që listat me emrat e të gjithë ofertuesve (dhe fituesve) të jenë të aksesueshme për publikun në çdo kohë.
- Për të përmirësuar zbatimin, Shqipëria duhet të trajtojë barrierat sistematike që nuk lejojnë mbledhjen dhe publikimin e datave të aplikimeve për licensat minerare dhe për të gjitha licensat hidrokarbure. Albeiti mund ta mbledhë dhe publikojë këtë informacion të paktën në të ardhmen, nëse nuk është e mundur paraprakisht. Datat e aplikimeve për licensat e naftës, gazit dhe minierave janë të dhëna të rëndësishme për të parë nëse ka pasur devijime përmbajtjesore në dhënien e licensës. Kjo vlen sidomos në rastin e ofertave konkurruese dhe në rastin e dhënies së licensave sipas metodës “i pari fitimtar”. Albeiti mund t'i publikojë datat e skadimit të licensave minerare dhe hidrokarbure për lehtësim aksesi.

Pronarët Përfitues (Kërkesa 2.5)**Tabloja e progresit në modul**

Përmbushja e Kërkesës 2.5 për pronarët përfitues është vlerësuar në Validim duke filluar nga 1 janari 2020-s, sipas kuadrit të miratuar nga bordi në qershor të 2019-s.³⁴ Vlerësimi përbëhet nga një vlerësim teknik që fokusohet të kriteret fillestare dhe një vlerësim efikasiteti.

Vlerësimi teknik

Raporti i EITI-t 2017-2018 qartëson përkufizimin dhe pozicionin e qeverisë rreth pronarëve përfitues. Ligji nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues” ka hyrë në fuqi në gusht të 2020-s dhe u kërkon të gjitha shoqërive në Shqipëri që të bëjnë publike informacionet për pronarët përfitues (PP). Regjistri i PP-ve mbahet nga QKB-ja ³², së bashku me regjistrin tregtar i cili përmban informacion publik rreth pronarëve³³ ligjorë. Regjistri i PP-ve u ngrit në vitin 2021, duke caktuar si afat për raportim nga ana e subjekteve tregtare datën 30 qershor 2021. MSG-ja është mbështetur te standardet dhe praktikat ndërkombëtare gjatë përcaktimit të përkufizimit të PP-ve, përkufizim ky i cili është qartësuar. Nëse një pronar përfitues qëllon të jetë Person i Ekspozuar Politikisht (PEP), pragu i PP-së zbritet në 10%. Kjo gjë ngre pikëpyetje lidhur me interpretimin e Kërkesave 2.5.d dhe 2.5.f.ii të EITI-t lidhur me pragjet e publikimit të PEP-ëve. Pavarësisht problematikës së interpretimit, asnjë prej publikimeve sistematike të aksesueshme publikisht nga QKB-ja nuk provon prani të ndonjë PEP-i, dhe asnjë PEP nuk duket të jetë identifikuar nëpërmjet raportimit të EITI-t. Raportimi i EITI-t nuk përfshin të dhëna për PP-të e shoqërisë.

PEP-ët i nënshtrohen ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe regjistrohen në

³¹ <https://eiti.org/document/assessing-implementation-of-eitis-beneficial-ownership-requirement>.

³² QKB (2021), “Regjistri i Pronarëve Përfitues”. I disponueshëm në: <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-e-pronareve-perfitues-rpp/k%C3%ABrko-p%C3%ABr-subjekt-raportues/>

³³ QKB (2021), “Regjistri Tregtar”. I disponueshëm në: <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Asnjë prej konstatimeve ose pasurive të deklaruara pranë kësaj drejtorie nuk duket të jetë e aksesueshme publikisht. Për më tepër, komentet nga MSG-ja treguan se Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të interesit është agjencia e vetme përgjegjëse për hetimin dhe kontrollin e depozitimeve të PEP-ëve. Duke u nisur nga konsultimet me palët e interesit dhe dokumentacioni, Albeiti duket se ka pasur angazhim të kufizuar me subjektet e lartpërmendura dhe deri më tani duket se formularët e raportimit që plotësohen nga shoqëritë raportuese ose të publikimet e QKB-së janë të kufizuara (pasi nuk përfshijnë tregues për PEP).

Si pjesë e raportimit të EITI-t, Albeiti ka kërkuar të dhëna për PP-të nga 127 shoqëri materiale (raportuese). Nga 127 shoqëri që kanë raportuar pranë Albeiti-t në vitin 2018, vetëm 59 kanë deklaruar të dhëna rreth PP-ve. Raporti i referohet "Shtojcës 4" për të dhëna të detajuara rreth PP-ve të depozituara nga 59 shoqëri, por kjo shtojcë nuk figuron në Raportin e EITI-t në gjuhën angleze. Versioni i Shtojcës 4 në shqip konfirmon se gjatë periudhës së raportimit 2017-2018 nuk janë bërë publike të gjitha të dhënat rreth PP-ve dhe e vë theksin te sfidat e shumta dhe rekomandimet për progres. Megjithatë, në dijeninë e Sekretariatit të EITI-t, janë kërkuar të gjitha të dhënat e parashikuara nga Standardi EITI (me përjashtim të aspekteve lidhur me PEP-të dhe shoqëritë në listat publike).

Ndonëse raportimi EITI-t ka kërkuar informacion vetëm për shoqëritë materiale, të gjitha shoqërive të regjistruara në Shqipëri u është kërkuar të japin të dhëna rreth pronarëve përfitues për t'u hedhur në regjistrin tregtar deri më 30 qershor 2021, ose brenda 30 ditësh nga themelimi. Kjo vlen për të gjitha shoqëritë e regjistruara në Shqipëri, pra për të gjitha shoqëritë të cilave u është dhënë licensë apo kontratë për minierat dhe naftën. Megjithatë, nuk ka asnjë vështrim të përgjithshëm lidhur me shoqëritë që i kanë raportuar dhe shoqëritë që nuk i kanë raportuar të dhënat për pronarët përfitues pranë Albeiti-t. Vetëvlerësimi i Albeiti-t konfirmon se nuk janë kërkuar garanci të tjera shtesë për raportimin e PP-ve nga ana e shoqërive përveç garancive për publikimet financiare.

Vlerësimi i MSG-së për publikimet e PP-ve (që prej dhjetorit të 2020-s, që është edhe data e publikimit të shtojcës 4 të raportit të EITI-t për vitin 2018) vëren se sfida e kuadrit aktual ligjor dhe ndryshimet e planifikuara në legjislacion dhe rregullore synojnë përmirësimin e mbledhjes dhe publikimit të të dhënave. Në vitin 2018, MSG-ja ndërmori anketimin e PP-ve për 127 shoqëritë e regjistruara dhe mori vetëm 59 përgjigje, prej të cilave 23% ishin të pjesshme. Vetëm një shoqëri në sektorin e naftës dhe gazit u përgjigj plotësisht. MSG-ja kreu më pas kontrollin e kryqëzuar të raportimit të shoqërisë duke e krahasuar me informacionin e disponueshëm nga Qendra kombëtare e biznesit dhe doli se 87.7% e të dhënave përputheshin plotësisht. Mospërputhjet vinin si rezultat i raportimit të pjesshëm të informacionit, gabimeve në raportim për shkak se disa pronarë i kishin shitur aksionet e tyre dhe pasaktësive në raportim pasi pyetjet e anketimit nuk ishin kuptuar si duhet. Megjithatë, të dhënat e raportuara të cilave Albeiti po i referohet teksa flasim nuk janë bërë publike deri më tani për shoqëri. Kështu, Albeiti nuk ka mundur të paraqesë tablonë e shoqërive nxjerrëse që i kanë publikuar pronarët e tyre përftues dhe ligjorë, ose se cilave bursa në listën publike po u japin informacion shoqëritë mëmë.

Vlerësimi i efikasitetit

Palët e konsultuara nëpërmjet Validimit lanë të nënkuptojnë se publikimi i PP-ve në Shqipëri ka nisur menjëherë pas fillimit të Validimit, por ende nuk ka një tablo të qartë rreth atyre që i zotërojnë dhe i kontrollojnë shoqëritë nxjerrëse në Shqipëri. Në kohën e publikimit të Raportit të EITI-t 2017-2018, QKB-ja nuk i bëri publike të dhënat për PP-të. Sidoqoftë, QKB-ja e ka ngritur regjistrin publik përkatës që prej fillimit të Validimit. Në përputhje me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale, regjistri i PP-ve, që është i aksesueshëm publikisht, nuk e

përfshin datën e plotë të lindjes (vetëm muajin dhe vitin), dhe as adresën e pronarit përfitues, por kjo e dhënë mund të merret përmes një kërkesë të veçantë dhe të arsyetuar. Regjistri përmban të dhëna publike si emrin e plotë, shtetësinë, datën e kualifikimit si pronar përfitues, përfshi edhe përqindjen e aksioneve që zotëron dhe nëse kontrolli është direkt apo indirekt. Konsultimet me palët e interesit treguan se QKB-ja ndërmerr disa kontrole për të verifikuar vërtetësinë e informacionit rreth PP-ve, por mbetet ende e paqartë se çfarë përfshin ky informacion. Sekretariati Ndërkombëtar, nëpërmjet një kampioni prej 10 shoqëri nxjerrëse,³⁴ ka vlerësuar nëse këto 10 shoqëri kanë publikuar të dhëna në regjistrin e QKB-së. Gjashtë kanë publikuar të dhëna të plota, dy të pjeshme, ndërsa dy të tjera nuk ndodheshin fare në regjistrin gjatë periudhës së vlerësimit (shihni Shtojcën A). Njëra prej këtyre shoqërive është ndërmarrje me 100% të kapitalit në pronësi shtetërore, ndërsa tjetra është shoqëri e huaj.

Vlerësimi dhe konsultimet me palët e interesit konfirmuan se shoqëritë e huaja dhe ato të renditura në listat publike nuk kishin raportuar se në cilat bursa ishin kuotuar, dhe as se kujt tikeri apo identifikuesi i raportojnë. Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit kanë treguar se në vitin 2021 janë bërë ndryshime të mëgejshme të ligjeve BO, megjithëse një rishikim i ndryshimeve nuk duket se i adreson të gjitha çështjet, si identifikimi i kompanive mëmë të cilat janë të renditura publikisht në bursat (e huaja).³⁵ Shqipëria duket se nuk ka treg funksional bursash, por nevojitet verifikim i mëtejshëm për të përcaktuar nëse shoqëritë nxjerrëse që veprojnë në Shqipëri mund të kuotohen publikisht në bursën ndërkombëtare. Shoqëritë në listat publike raportojnë si pronarë përfitues përfaqësuesit më të lartë ligjorë (zakonisht drejtuesit ekzekutivë). Po e njëjta procedurë vlen edhe për shoqëritë që nuk janë në gjendje t'i identifikojnë dhe raportojnë pronarët e tyre përfitues përkatës. Pas shqyrtimit të kampionit prej 10 shoqërive në regjistrin tregtar të QKB-së, doli se ka të dhëna për pronësinë ligjore për të gjitha shoqëritë, përfshi edhe përqindjen dhe llojin e pronësisë ligjore që kanë.

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave të EITI-t ose masave korrigjuese është mundësuar falë modeleve tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur në shtojcën e këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Pronarët përfitues (Kërkesa #2.5)	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për t'i bërë me dije publikut se kush i zotëron dhe kontrollon shoqëritë që veprojnë në fushën e industrive nxjerrëse në vend. Janë trajtuar pjesa më e madhe e aspekteve të Fazës I të kërkesave lidhur me pronarët përfitues, pasi të gjitha shoqërive në Shqipëri u janë kërkuar të dhëna rreth PP-ve (jo vetëm ato që zotërojnë ose aplikojnë për licenca nxjerrëse). Megjithatë, në vlerësimin e MSG-së për gjithanshmërinë dhe besueshmërinë e publikimeve rreth PP-ve, Albeiti duket se nuk ka informacion të aksesueshëm publikisht për shoqëri (publikojnë vetëm përfundimet, jo të dhënat për PP-të). MSG-ja nuk i ka vlerësuar ende</p>	Përmbushur kryesisht

³⁴ Kampioni përfshiu pesë shoqëritë me të ardhurat më të mëdha dhe pesë shoqëri të përzgjedhura krejt rastësisht nga lista e shoqërive në formularin e Transparencës, faqja "#4.1 - Subjektet raportuese". Më 6 tetor 2021, për të marrë informacion në QKB rreth pronarëve përfitues kërkuam me NIPT-in e shoqërisë.

³⁵ QKB (2021), 'Ligji nr. 12 për ndryshimet dhe shtesat në Ligjin nr. 112/2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues"'. E disponueshme në: <https://qkb.gov.al/media/38122/akti-normativ-nr-12-date-25032021-per-rpp-botuar-ne-fz-nr-49-date-29032021.pdf>

	<p>publikimet nëpërmjet regjistrimit të ri për pronarët përfitues të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Albeiti duket se nuk ka, të paktën tani për tani, një listë të PP-ve ose pronarëve ligjorë të shoqërive materiale. Regjistri i Pronarëve Përfitues ka disa mangësi lidhur me publikimet e pronarëve përfitues dhe nuk tregon se cilat shoqëri janë në listën publike të bursave (të huaja). Ndonëse regjistri përfshin disa informacione rreth PP-ve, nuk tregon nëse pronarët përfitues janë persona të ekspozuar publikisht (PEP) dhe legjislacioni aktual nuk garanton nëse çdo PEP i cilësdo shoqëri publikohet si PP, pavarësisht nivelit të kontrollit. Pronarët ligjorë të shoqërive nxjerrëse publikohen në QKB. Së fundi, Raporti i EITI-t tregon qartë se nuk ka metoda ose mjete aktuale verifikimi nga agjencitë qeveritare, me përjashtim të penalteteve për mospublikim ose publikime të pasakta.</p>	
Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet		
<ul style="list-style-type: none"> Në përputhje me kërkesën 2.5 dhe për t'u përgatitur për fazën II të Validimit të Kërkesës 2.5 nga janari i 2022-shit e në vijim, Shqipërisë i kërkohet të garantojë publikimin e të gjithë pronarëve përfitues të të gjitha shoqërive që zotërojnë ose aplikojnë për licensë në sektorin e minierave, naftës dhe gazit në mënyrë sa më të gjithanshme dhe të besueshme, duke filluar nga janari i 2022-shit. Ndërkohë, në përputhje me Kërkesën 2.5.c, Shqipërisë i kërkohet të sigurojë që MSG-ja të publikojë vlerësimin e gjithanshmërisë dhe besueshmërisë së publikimeve rreth pronarëve përfitues të çdo shoqërie që zotëron ose aplikon për licensë në sektorin e minierave, naftës dhe gazit. Në përputhje me Kërkesën 2.5.d, Shqipëria duhet të sigurohet që personat e ekspozuar politikisht që zotërojnë aksione direkte ose indirekte në shoqëri nxjerrëse në Shqipëri, të jenë identifikuar publikisht ose përmes raportimit të EITI-t ose nëpërmjet portaleve qeveritare të aksesueshme publikisht. Nëpërmjet MSG-së, Shqipëria nxitet të rishikojë pragjet për raportimin e PEP-ëve, për të siguruar përafrim me Kërkesat 2.5.d dhe 2.5.f.ii. Shoqërive në lista publike, sidomos filialet e shoqërive të kuotuar në bursë, u kërkohen të bëjnë publike emrin e bursës dhe të përfshijnë edhe një link të depozitimeve që kanë bërë pranë bursës ku janë regjistruar, në përputhje me Kërkesën 2.5.f.iii. 		

Pjesëmarrja e shtetit (Kërkesat 2.6, 4.2, 4.5, 6.2)

Tabloja e progresit në modul

Raporti i EITI-t 2017-2018 rendit në mënyrë të gjithanshme të gjitha interesat e Shqipërisë në shoqëritë e sektorit minerar si dhe identifikon NSh-në e vetme që operon në sektorin e eksplorim-shfrytëzimit të naftës: Albpetrolin. Raporti qartëson praktikatat statutorë dhe aktuale të marrëdhënieve financiare të Albpetrolit me shtetin. Raporti i EITI-t 2017-2018 sqaron çdo ndryshim të interesave të Shqipërisë në sektorë, si dhe termat për sa i përket kapitalit shtetëror. Në vitin 2018, shoqërive nxjerrëse nuk iu dha asnjë hua ose garanci shtetërore, ndonëse pasqyrat financiare të audituara të Albpetrolit treguan se ekzistonin dy hua: një nga MFE-ja dhe një nga një institucion bankar privat. Kjo gjë u konfirmua gjatë konsultimeve me palët e interesit, dhe komentet e MSG-së për projektvlerësimin konfirmuan se Albpetrol ka të drejtën, dhe praktikisht kjo është e vërtetë, të kërkojë financim borxhi të palëve të treta, si edhe për sigurimin e dokumentacionit shtesë për zbulimet sistematike të Albpetrol. Krahas sektorit nxjerrës, vlen për t'u përmendur se sektori hidroenergjetik dominohet nga ndërmarrjet shtetërore dhe interesat e qeverisë shqiptare për kapital. Megjithatë, në vitin 2018 nuk është paguar asnjë dividend. Shteti shqiptar vepron edhe si garantor në sektorin bankar për hua që mund t'i jepen NSh-ve në sektorin e hidroenergjetikës, ku për hidroenergjetikën ka më tepër detaje se për sektorët e tjerë (shihni më poshtë). Kështu, Sekretariati vlerëson se objektivi i Kërkesës 2.6 është përmbushur.

Shqipëria duket se vijon ta përmbushë objektivin e Kërkesës 4.2, duke dokumentuar të ardhurat në natyrë për sektorët e naftës, gazit dhe minierave. Këto pagesa nuk ekzistojnë në sektorin mineral. Në sektorin e naftës, Albpetroli mbledh, shet dhe përvetëson të gjitha produktet e të ardhurave shtetërore në natyrë. Çdo transfertë në favor të qeverisë bëhet përmes pagesave të dividendëve kundrejt qeverisë si aksionar. Raporti i EITI-t përmban informacion rreth shitjes së naftës në natyrë, identitetit të blerësve, çmimeve, numrit dhe datës së kontratës, të gjitha këto të disagreguara sipas dërgesave individuale. Krahasuar me vitet e mëparshme të raportimit, shitjet nuk disagregohen më sipas ngarkesës. Megjithatë, çdo proces shitjeje dhe ankandi publikohet sistematikisht nga Albpetroli në faqen e vet të internetit.³⁶

Raporti i EITI-t 2017-2018 i përshkruan qartësisht të ardhurat e mbledhura nga Albpetroli. Asnjë pagesë dividendësh apo e ardhur tjetër nuk i ka shpëtuar tatimit në vitin 2018. Në sektorin e naftës dhe gazit, nuk ka pasur transferta midis shtetit dhe NSh-së gjatë vitit objekt vlerësimi. Seksioni që i kushtohet transfertave midis shtetit dhe NSh-ve në sektorin e hidrokarbureve është ekzemplar, ku shpjegohet edhe mënyra se si shteti i injekton fondet në sektor përmes investimeve në kapital dhe huadhënies direkte në favor të shoqërive shtetërore. Për sa i përket gjithanshmërisë dhe besueshmërisë së të dhënave, Albpetroli dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) kanë qenë të vetme NSh në sektorin e hidrokarbureve që kanë ofruar pasqyra financiare për raportimin EITI. Të dyja u janë nënshtruar dy auditeve, të cilat Raporti EITI vëren se kanë pasur një “nivel mesatar sigurimi”. Shqipëria duket se vijon ta përmbushë objektivin që ta ndihmojë publikun t’i kuptojë më mirë transaksionet që përfshijnë NSh-të dhe shoqëritë e tjera ose qeverinë.

Për sa i përket shpenzimeve kuazi fiskale, palët e konsultuara të interesit kanë rënë dakord midis tyre se nuk ka pasur shpenzime kuazi fiskale të financuara nga Albpetroli gjatë vitit objekt vlerësimi. Për më tepër, pasqyrat e audituara financiare të Albpetrolit, të cilat nuk përmbanin asnjë objeksion nga një auditues i kualifikuar, nuk i përmendnin fare shpenzimet kuazi fiskale. Kështu, shpenzimet kuazi fiskale duket se vijnë të mos jenë të zbatueshme në Shqipëri.

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave të EITI-t ose masave korrigjuese është mundësuar falë modeleve tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur në shtojcën e këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Pjesëmarrja e shtetit (Kërkesa 2.6)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur plotësisht objektivin e Kërkesës 2.6 për të siguruar një mekanizëm efikas transparence dhe llogaridhënieje për mirëqeverisjen e NSh-ve dhe pjesëmarrjen e shtetit, si dhe për ta bërë publikun të kuptojë nëse menaxhimi i NSh-ve është bërë në përputhje me kuadrin përkatës rregullator. Albpetroli konsiderohet të jetë NSh-ja e vetme në sektorin nxjerrës të eksplorim-shfrytëzimit, pasi sektori i hidrokarbureve nuk është i mbuluar nga Validimi. Krahas kësaj, theksi vihet te dy NSh-të në sektorin nxjerrës të depozitim-transportimit, ndonëse nuk janë materiale: Transnafta Sh.a. and Albgaz. Pjesëmarrja e shtetit në Albpetrol sjell grumbullimin e të ardhurave materiale përmes pagesave të dividendëve që Albpetrol bën në favor të shtetit si aksionar i	Përmbushur plotësisht

³⁶ Albpetrol (2021), “Ankand për shitjen e naftës së papërpunuar”. I disponueshëm në: <https://www.albpetrol.al/en/auction-for-sale-of-crude-oil-by-albpetrol-sh-a-07-04-2021/>

	vetëm i tij. Këto pagesa përcaktohen me të njëjtat terma si për shoqëritë private dhe përmes të ardhurave shtetërore në natyrë nga shitjet. Raporti i EITI-t për periudhën 2017-2018 qartëson rregullat dhe praktikat lidhur me aftësinë e Albpetrolit për të mbledhur financime nga palë të treta dhe dokumentuar ndryshimet në pjesëmarrjen e shtetit gjatë vitit objekt vlerësimi. Për praktikën e qeverisjes së NSH-së, Raporti i EITI-t mbështetet te pasqyrat financiare të audituara të Albpetrolit, të cilat janë të aksesueshme publikisht, për të dokumentuar huat e Albpetrolit nga bankat private. Raporti i EITI-t për periudhën 2017-2018 vëren mungesën e huave shtetërore në favor të shoqërive private në sektorin e minerave, gazit dhe naftës, përfshi edhe mungesën e garancive shtetërore.	
Shitja e të ardhurave shtetërore në natyrë (Kërkesa #4.2)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar transparencë lidhur me shitjen e të ardhurave në natyrë të minerareve, naftës dhe gazit, për t'i dhënë mundësinë publikut të vlerësojë nëse vlerat e shitjeve përkojnë me vlerat e tregut dhe për të siguruar gjurmueshmërinë e produkteve nga shitja e këtyre mallrave në Thesarin kombëtar. Raporti i EITI-t për periudhën 2017-2018 përcakton sasinë e mbledhura, sasinë e shitura dhe produktet e shitjes si për përqindjen e prodhimit të naftës sipas KNP-ve, ashtu edhe për naftën kapital të Albpetrolit. Nuk bëhet ndarje midis kapitalit dhe përqindjes së fitimit nga prodhimi. Megjithatë, çdo proces shitjeje dhe ankandit publikohet sistematikisht nga Albpetrolit në faqen e vet të internetit. ³⁷ Krahasuar me Validimin e mëparshëm, shitjet nuk disagregohen më sipas ngarkesës, gjë që nxitet nga ana e EITI-t, ndonëse nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me aspektet e Kërkesës 2.4, e cila është vlerësuar në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”.	Përbushur plotësisht
Transaksionet lidhur me ndërmarrjet shtetërore (Kërkesa #4.5.)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur plotësisht objektivin e Kërkesës 4.5 për të siguruar gjurmimin e pagesave dhe transfertave që përfshijnë NSh-të dhe për ta bërë publikun të kuptojë më mirë nëse të ardhurat e grumbulluara nga shteti janë transferuar në mënyrë efikase, si dhe nivelin e mbështetjes financiare shtetërore për NSh-të. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 4.5, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”. Ka ende vend që detajet shtesë të publikuara për transaksionet e NSh-ve në sektorin e hidrokarbureve të publikohen edhe për sektorin e naftës. Kjo gjë mund të jetë tepër e rëndësishme që raportimi i EITI-t të fillojë të mbulojë edhe sasinë e transportimit të gazit shqiptar nga Albgazi. Niveli i progresit kundrejt përbushjes së kësaj kërkesë ka qenë i njëjtë që prej Validimit të fundit.	Përbushur plotësisht
Shpenzimet kuazi fiskale (Kërkesa #6.2)	Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 6.2, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm se “nuk gjën zbatim”. Sipas Raportit, MIE dhe Albpetrolit janë shprehur se legjislacioni dhe rregulloret që rregullojnë veprimtarinë e Albpetrolit nuk përfshijnë shpenzime kuazi fiskale apo rregullime të tjera të ngjashme. Megjithatë, nuk shpjegohet metodologjia e ndjekur për arritjen e këtij përfundimi. Palët e interesit bien dakord se nuk ka pasur shpenzime kuazi fiskale për vitin objekt vlerësimi. Pasqyrat financiare të Albpetrolit janë audituar sipas standardeve	E pazbatueshme

³⁷ Albpetrol (2021), “Ankand për shitjen e naftës së papërpunuar”. I disponueshëm në: <https://www.albpetrol.al/en/auction-for-sale-of-crude-oil-by-albpetrol-sh-a-07-04-2021/>

	ndërkombëtare dhe nuk i referohen përgjegjësive jotregtare, dhe as nuk përmbajnë objeksion të ndonjë audituesi të kualifikuar.	
Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet		
<ul style="list-style-type: none"> • Për ta përmirësuar zbatimin, Shqipëria mund të marrë në konsideratë t'i rikthehet praktikës së 2016-s së publikimit të mallrave tregtare, ku të gjitha shitjet e naftës disagregoheshin sipas ngarkesës, në përputhje me Kërkesën 4.2.c. Për të shënuar progres kundrejt publikimit sistematik, Albpetroli nxitet të bashkëpunojë me rrjetin e EITI-t për mallrat për sa i përket publikimit të të dhënave rreth shitjeve të naftës të disagreguara sipas ngarkesës në faqen e vet të internetit, si dhe për të siguruar publikime sistematike për rregullat dhe praktikat lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, prokurimin, nënkontraktimin dhe qeverisjen korporative, sipas Kërkesës 2.6.c. • Për ta përmirësuar zbatimin, Shqipëria mund t'i rikthehet punës ekzemplare të bërë për transaksionet financiare midis shtetit dhe NSh-së në sektorin hidroenergjetik dhe të ofrojë të njëjtin nivel mbulimi në sektorët e eksplorim-shfrytëzimit dhe depozitim-transportimit të naftës. • Për të siguruar përmbushjen e Kërkesave EITI, Shqipëria nxitet të sigurojë që, për të përcaktuar nëse shpenzimet kuazi fiskale janë të zbatueshme, të përdoren vetëm të dhënat e raportuara gjatë periudhës së raportimit në fjalë dhe të mos citohen si prova Validimet ose Raportet e mëparshme të EITI-t. Albeiti duhet të mbështetet te vlerësimi i materialitetit për t'u siguruar nëse këto kërkesa janë të zbatueshme apo jo. 		

Prodhimi dhe eksportet (Kërkesat 3.2, 3.3)

Tabloja e progresit në modul

Detajet për sasi të dhe vlerat e prodhimit mineral janë paraqitur në Raportin e EITI-t 2017-2018 të disagreguara sipas mallrave. Në mënyrë të ngjashme, portali i AKBN-së i publikon shifrat e prodhimit të disagreguara sipas mallrave, për gamë të gjerë mallrash dhe për nënmallra, ndonëse këtu përfshihen vetëm sasi të prodhimit. Edhe prodhimi i naftës dhe gazit përfshihet në Raportin e EITI-t, i disagreguar sipas mallrave dhe fushës së naftës, ku fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinzës e shfrytëzuar nga Bankers Petroleum përfaqëson më tepër se 87% të prodhimit të përgjithshëm. Të gjitha shifrat e prodhimit janë të disponueshme edhe në format të hapur të të dhënave të mbledhura për Shqipërinë. Raporti i EITI-t përmban një seksion të detajuar dhe novator për prodhimin e elektricitetit nga HEC-et, duke bërë edhe një krahasim midis energjisë së prodhuar dhe energjisë së instaluar në vend dhe sasisë së TWh të prodhuar çdo vit. Raporti jep të dhëna edhe për konsumin e brendshëm, si dhe për humbjet në rrjetin e transportimit të elektricitetit. Nga raportimi dhe konsultimet e Albeitit-t u konfirmua se objektivi i dhënies së detajeve rreth sasive dhe vlerave për çdo mall të prodhuar në Shqipëri është përmbushur plotësisht. Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit nuk nënkuptonin se ka minerale të tjera të nxjerra në Shqipëri³⁸, edhe pse argumentohet se vëllimet dhe vlerat e prodhuara janë kaq të vogla sa që nuk janë përfshirë në Raportin EITI. Është dhënë shembulli i 150 tonëve të qymyrgurit të prodhuar me çmimin 15 USD për ton (pra me një vlerë prej 2.250 USD). Kjo gjë nuk është theksuar për vëllimet dhe vlerat e eksportit, edhe pse do të nënkuptonte se lista e mallrave të eksportuara mund të mos jetë gjithëpërfshirëse. Si përfundim, një rishikim i portalit të të dhënave të hapura të Albeitit³⁹ zbuloi se Albeiti nuk publikon të dhëna për disa prej mallrave

³⁸ Basalt, bitum, zhavorr bituminoz, rërë bituminoze, krom, argjilë, konglomerat, gur gëlqeror konglomerat, baker, gur gëlqeror dekorativ, gur ranor zhavorri, gips, gips (alabaster), hekur (nikel), gur gëlqeror, gur gëlqeror mermeri, gur gëlqeror masiv, kuarc, rërë kuarci, silikonit guri ranor, silikonit, gur gëlqeror pllakë, slope breccia, traventina dhe zhure.

³⁹ Albeiti (2020), 'Sektori Mineral [Open data portal: Mining sector]'. I disponueshëm në:

<https://www.opendata-albeiti.org/Mining>

të theksuara, gjë e cila nënkupton se objektivi i përgjithshëm i kërkesës nuk është përmbushur plotësisht.

Detajet për sasi të dhe vlerat e eksporteve janë detajuar në Raportin e EITI-t 2017-2018 të disagreguara sipas mallrave dhe vendit të destinacionit. Tre mallrat kryesore të eksportuara nga Shqipëria për sa i përket vlerës janë nafta, kromi dhe ferrokromi. Vlen për t'u vërejtur se në sektorin minerar, një përqindje e konsiderueshme e eksporteve të kromit vijnë nga shoqëri që supozohet të mos kenë licensë mbajtëse. Të gjitha sasi të dhe vlerat e eksporteve janë të disponueshme edhe në format të hapur, në formularët përmbledhës së të dhënave në Shqipëri. Nga raportimi dhe konsultimet e Albeitit-t u konfirmua se objektivi i dhënies së detajeve rreth sasive dhe vlerave të eksporteve për çdo mall të prodhuar në Shqipëri është përmbushur plotësisht.

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave të EITI-t ose masave korrigjuese është mundësuar falë modeleve tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur në shtojcën e këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Prodhimi (Kërkesa #3.2)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për ta ndihmuar publikun t'i kuptojë më mirë nivelet e prodhimit të mallrave nxjerrëse dhe vlerat e mallrave nxjerrëse të prodhuara, të cilat shërbejnë si bazë për trajtimin e problematikave të lidhura me prodhimin në industrinë nxjerrëse. Metodologjia për përcaktimin e vlerave të prodhimit bazohet te çmimet e shitjes së eksporteve. Ndërkohë që komentet nga MSG për draft-raportin e Validimit nënkuptonin se mund të ketë mallra që mungojnë në të dhënat e publikuara, portali i të dhënave i Albeitit nuk përfshin të dhëna mbi mallrat e theksuara. Prandaj, nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 3.2, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me "progres të kënaqshëm".	Përmbushur plotësisht
Eksportet (Kërkesa #3.3)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për ta ndihmuar publikun t'i kuptojë më mirë nivelet e eksportit të mallrave nxjerrëse dhe vlerat e mallrave nxjerrëse të eksportuara, të cilat shërbejnë si bazë për trajtimin e problematikave të lidhura me eksportin në industrinë nxjerrëse. Megjithatë, raporti vëren se 10% e eksporteve minerare vijnë nga shoqëri që nuk kanë leje minerare. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 3.3, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me "progres të kënaqshëm".	Përmbushur plotësisht

Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet

- Për ta përmirësuar më tej zbatimin, Shqipëria mund të marrë në konsideratë zbulimin e mallrave ekstraktive nëse ka vend për publikimin e shifrave të prodhimit të disagreguara sipas rajonit dhe projektit.
- Për të përmirësuar zbatimin, Shqipëria nxitet që të zbulojë të dhënat e prodhimit dhe eksportit, duke përfshirë si vëllimet edhe vlerat, për çdo mall të nxjerrë në Shqipëri, pavarësisht nga sasia e vogël e këtyre prodhimeve ose eksporteve. Për ta përmirësuar më tej zbatimin, MSG-ja nxitet të publikojë sistematikisht shifrat e prodhimit dhe eksporteve nëpërmjet agjencive përkatëse (AKBN dhe INSTAT), duke dhënë detaje të të njëjtit nivel me të raportimit EITI. Për zbulimin publik të të dhënave rreth prodhimit ose eksportimit të mallrave nxjerrëse, Shqipëria mund të marrë në konsideratë zbatimin e standardeve ndërkombëtare të të dhënave si Kodet e Sistemit të Harmonizuar për klasifikimin e mallrave në nivele me 4 ose 6 shifra, ose të tjerë të barasvlershëm.

Mbledhja e të ardhurave (Kërkesat 4.1, 4.3, 4.4, 4.7, 4.8, 4.9)

Tabloja e progresit në modul

Pas shqyrtimit të publikimeve përkatëse dhe konsultimeve me palët e interesit, Sekretariati arriti në përfundimin se, që prej Validimit të fundit, Shqipëria ka pasur të njëjtin nivel progresi lidhur me trajtimin e Kërkesave 4.3 për transaksionet e këmbimit dhe ofrimin e infrastrukturës, 4.4 për të ardhurat nga transporti dhe 4.8 për përshtatshmërinë kohore të të dhënave. Megjithatë, ajo çka vlen për t'u theksuar është se Albeiti ka konfirmuar sërish zbatueshmërinë e këtyre Kërkesave EITI mbi baza vjetore, në kuadër të zhvillimeve të sektorit. Për shembull, ndonëse as qeveria dhe as shoqëritë shtetërore nuk kanë gjeneruar të ardhura nga transporti i mallrave nxjerrëse për periudhën 2017-2018, vënia në punë e Gazsjellësit Trans Adriatik në vitin 2020 nënkupton se të ardhurat nga transporti do të shërbejnë me shumë gjasa si material për raportimin e EITI-t gjatë viteve të ardhshme.

Shqipëria nuk ka bërë progres të mëtijshëm lidhur me publikimin e gjithanshëm të pagesave të shoqërive dhe të ardhurat qeveritare nga gazi, nafta dhe minierat, që prej Validimit të dytë në vitin 2019. Vijnë të mbizotërojnë disa sfida të dokumentuara prej Validimeve të mëparshme. Së pari, po haset vështirësi me sigurimin e publikimeve të plota nga ana e qeverisë së të ardhurave nga sektori nxjerrës, pjesërisht edhe për shkak të sistemeve të monitorimit të agjencive qeveritare. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Administrata Doganore Shqiptare (ADSh) janë të kufizuara nga ligjet për konfidencialitetin tatimor për sa i përket ofrimit të të dhënave për procesin e EITI-t në Shqipëri, përveç rasteve kur shoqëritë heqin dorë nga e drejta e tyre për konfidencialitetin tatimor. Kjo vlen edhe për shifrat e agreguara, çështje kjo e ngritur në konsultimet e palëve të interesit me përfaqësuesit qeveritarë. Si pjesë e komenteve të saj për draft-raportin e Validimit, MSG-ja ka theksuar se DPT publikon një raport vjetor në faqen e saj të internetit⁴⁰, megjithëse një rishikim i raportit nuk ka zbuluar të dhëna të sakta mbi të ardhurat e sektorit të gërmimit, të ndara sipas rrjedhjeve individuale të të ardhurave dhe shoqërive.

Konsultimet me palët e interesit konfirmojnë gjithashtu se problematika është e dyfishtë: (i) pas regjistrimit, shoqëritë i përcaktojnë “veprimtaritë e tyre parësore” sipas klasifikimit kombëtar të veprimtarive ekonomike, i cili përkon me Standardin ISIC të Sistemit të Kombeve të Bashkuara për Llogaritë Kombëtare. Megjithatë, shoqëria mund të mos jetë titullare e të drejtave nxjerrëse. (ii) Nga ana tjetër, konsultimet konfirmuan se titullarët e të drejtave nxjerrëse ushtrojnë edhe veprimtari të tjera ekonomike si veprimtari parësore, gjë që do të thotë se pagesat tatimore nuk mund t'i atribuohen vetëm veprimtarive nxjerrëse.

Raporti i EITI-t 2017-2018 nuk jep të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar totalin e të ardhurave qeveritare nga shoqëritë nxjerrëse dhe ka mospërputhje midis shifrave në Raportin e EITI-t dhe depozitimeve të MSG-së në kuadër të këtij Validimi. Raporti i EITI-t shpreh qartësisht se të dhënat mbulojnë vetëm pagesat e konsiderueshme që janë bërë nga të licensuarit dhe nuk përfaqësojnë të listën e të gjitha pagesave. Si sfida shihet edhe ndërlikimi i tabelave të shumta

⁴⁰ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), 'RAPORTI VJETOR 2018 [Annual report 2018]'. I disponueshëm në: <https://www.tatime.gov.al/c/8/42/49/strategjia-dhe-raporte>

në Raportin e EITI-t (shihni Shtojcën B të këtij raporti).⁴¹ Disa lloje të ardhurash nuk janë raportuar, ose janë raportuar vetëm për shoqëritë e përfshira në objektin e rakordimit: tarifa shërbimesh dhe licensash, bonuse trajnimi, bonuse firme, tatimi mbi vlerën e shtuar për importet (TVSH-ja e importit), akciza, taksa e karbonit, të ardhura të tjera nga importi dhe “të ardhura të tjera” të gjeneruara nga AKBN-ja dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh). Kështu, nuk mund të arrihet në përfundimin se qeveria ka bërë publikime të plota rreth të ardhurave nga sektori nxjerrës, të disagreguara sipas llojeve të të ardhurave individuale. Nga ana tjetër, falë konsultimeve me palët e interesit u konfirmua se (provuar nga dokumentacionet e palëve të treta) pagesat mjedisore në favor të qeverisë nuk janë materiale në Shqipëri, qoftë edhe në nivel nënkombëtar, pa iu referuar të dhënave apo provave të veçanta. Për më tepër, Raporti i EITI-t pretendon se asnjë prej këtyre përjashtimeve nuk ndikon në mënyrë të konsiderueshme te gjithanshmëria e raportimit, nëse nuk provohen shifrat dhe vlerat përkatëse.

Dy shoqëri materiale gazi dhe naftë, 31 shoqëri materiale minerare dhe gjashtë shoqëri materiale hidrokarbure nuk bënë asnjë raportim në kuadër të Raportit të EITI-t 2017-2018. Për më tepër, dy agjenci qeveritare nuk kanë raportuar: MFE-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Ndonëse raporti nuk tregon vlerat e pagesave që ka bërë secila shoqëri dhe agjenci qeveritare joraportuese, raporti tregon se dy prej shoqërive joraportuese në vitin 2018 përfaqësonin më tepër se 1% të të ardhurave të përgjithshme. Ndonëse niveli i rakordimit pretendohet të jetë 99.45%, llogaritja alternative e bazuar te informacioni i depozituar nga MSG-ja në kuadër të këtij Validimi tregon se niveli i rakordimit është 48%.⁴² Edhe mbulimi i të ardhurave të njërive të qeverisjes vendore (NjQV) dhe pagesave mjedisore mbetet i paqartë, pasi varen nga arkëtimet e vërteta totale të qeverisë (*shihni Kërkesat 4.6 dhe 6.1*).

Shqipëria nuk ka bërë progres të konsiderueshëm lidhur me përmirësimin e besueshmërisë së publikimeve rreth pagesave të shoqërive dhe të ardhurave të qeverisë nga nafta, gazi dhe minierat krahasuar me Validimin e fundit. Ç’është e vërteta, u konfirmua se qasja e MSG-së për sigurimin e besueshmërisë së të dhënave të EITI-t nuk ka ndryshuar në thelb, gjë që u theksua edhe në Raportin e EITI-t 2017-2018, edhe në konsultimet me palët e interesit. Komentet e MSG-së nënkuptonin se kjo është për t’u marrë në konsideratë për Raportet EITI në të ardhmen.

Raporti i EITI-t nuk përmban asnjë deklaratë të Administratorit të Pavarur lidhur me gjithanshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave financiare të rakorduara në raportin e EITI-t. Për sa u përket praktikave aktuale të auditimit, raporti konfirmon se 45% e të ardhurave të rakorduara vinin nga subjekte tregtare që u ishin nënshtruar auditimit në vitin 2018, duke shënuar kështu një përmirësim të vogël që prej Validimit të 2019-s. Megjithatë, raporti vijon të mos japë asnjë listë gjithëpërfshirëse të praktikave të raportimit për çdo shoqëri materiale. Për shoqëritë që iu nënshtrohen auditimit, këto të dhëna janë të aksesueshme nëpërmjet regjistrit tregtar të QKB-së. Raporti i EITI-t qartëson edhe se janë audituar pasqyrat financiare të vetëm 25 nga 155 shoqërive, ku ka pasur vetëm një opinion të ndryshuar auditimi, pa identifikuar subjektet e ndryshme raportuese. Asnjë prej subjekteve raportuese të qeverisë nuk u janë nënshtruar auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH). Megjithatë, faqja e internetit të KLSH-

⁴¹ Tabelat 14, 23, 28, 36 dhe 37 duket se ofrojnë llogaritjet më të përafërta të publikimeve të plota të qeverisë të disagreguara sipas llojit të të ardhurave, por shënimet në fund të tabelave tregojnë se disa lloje të ardhurash janë dhënë në formë agregati nga “shoqëritë materiale”. Disa llogaritje “të tjera” nuk janë disagreguar dhe pagesat direkte në favor të NjQV-ve ose Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nuk janë përfshirë në tabela.

⁴² Sipas formularit të Transparencës, faqja “#4.1 - Shoqëritë” pjesëtuar me “#4.1 - Qeveria”, del se janë mbuluar vetëm 48% e të ardhurave. Nëse tabelat 14,23,28,36 dhe 37 c përfshijnë të gjitha publikimet qeveritare (44.52 miliard lekë), atëherë niveli i mbulimit bie në 40%.

së tregon se të gjitha raportet e auditimit janë të aksesueshme për publikun.⁴³ Këto zbulime u konfirmuan nga komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit. Komentet e mëtejshme duket se theksojnë që Albeiti nuk ka ruajtur të gjitha të dhënat e detajuara dhe bazën e informacionit për Raportin EITI. Kjo thekson rëndësinë që Albeiti të bëjë një rishikim të plotë se cilat pasqyra financiare të audituara nga ente qeveritare dhe korporative janë në fakt të aksesueshme përmes portaleve të QKB-së ose portaleve të tjera, dhe t'i përmbledhë këto zbulime si pjesë të raportimit EITI.

Së fundi, ndryshimi më i rëndësishëm krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit është se Albeiti ka kërkuar verifikimin ex-post të gjithanshmërisë së rakordimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Administrata Doganore Shqiptare (ADSh), por është marrë parasysh vetëm vlerësimi i ADSh-së. Sipas ADSh-së, rakordimi mbuloi 84% të rentave të eksportit në vitin 2018. AP-ja nuk e ka marrë parasysh vlerësimin e DPT-së pasi sistemet e DPT-së mbështeten te një standard i papajtueshëm i të dhënave, gjë e cila përcakton aktivitet industrial të shoqërive bazuar vetëm në aktivitetet kryesore. AP-ja argumentoi se kjo është e papajtueshme me ato shoqëri që kishin marrë licenca dhe kontrata, dhe për pasojë që i bënë pagesa qeverisë.

Albeiti ka filluar t'i raportojë disa të ardhura sipas "projektit", në kuadër të një KNP-je për shoqëritë e naftës, një license të vetme për shoqëritë minerare, ose një koncesioni të vetëm për hidrokarburet. Këto janë në përputhje me përkufizimin e "projektit" sipas standardit EITI. Sipas Raportit të EITI-t, vetëm një zë i të ardhurave mbledhet në nivel projekti: renta.

Megjithatë, në raportimin sipas projektit hasen sfida pasi disa shoqëri kanë disa licenca nxjerrëse, edhe pse sistemet qeveritare ku është mbështetur raportimi i EITI-t i regjistrojnë pagesat për NIPT (numri unik i identifikimit të taksapaguesit). Kjo vlen për të gjitha zërat e të ardhurave, qofshin në nivel projekti ose jo. Raporti i EITI-t nuk përfshin asnjë vlerësim nëse licensat e ndryshme të shoqërive mund të konsiderohen si një projekt i vetëm, qoftë si veprimtari të bashkëlidhura, qoftë në kuadër të një marrëveshjeje të përgjithshme.⁴⁴ Konsultimet me palët e interesit konfirmuan se disa shoqëri kanë një fabrikë përpunimi që i shërben disa licensave minerare, ku rentat paguhen në nivelin e fabrikës përpunuese, ndonëse këto shoqëri nuk janë identifikuar shprehimisht dhe MSG-ja nuk i konsideron ato si një projekt i vetëm. Raporti i EITI-t konfirmon se vetëm 16 nga 35 shoqëri me shumë licenca kanë raportuar sipas projektit. Edhe këtu, Raporti i EITI-t 2017-2018 nuk përfshinte të dhëna të disagreguara më tej se niveli i NIPT-it (shoqërisë) Kështu, raportimi në nivel projekti ndodh vetëm kur shoqëritë zotërojnë vetëm një licensë. Sikurse u konfirmua prej palëve të konsultuara të interesit nga shoqëria civile, qeveria dhe industria, kjo do të thotë se Shqipëria nuk e ka përmbushur ende objektivin e raportimit në nivel projekti. Përqindja faktike e të ardhurave të rakorduara të mbledhura për projekt, të cilat publikohen të disagreguara, mbetet ende e paqartë duke marrë parasysh raportet dhe formularët aktualë.⁴⁵ Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit konfirmuan mungesën e ndarjes së plotë nga të gjitha projektet e ekstraktimit. Komentet sugjerojnë të ndërmerret një studim, i cili do të rishikojë bazën ligjore për raportimin në nivel projekti si pjesë e një granti të ri

⁴³ KLSH (2021), 'Auditimet'. Të disponueshme në: <https://www.klsh.org.al/>

⁴⁴ Shihni Udhëzimin e EITI-t për hyrjen në këto koncepte: <https://eiti.org/GN29>

⁴⁵ Të dhënat nga formulari i Transparencës tregojnë se nga 90 milionë dollarë amerikanë të mbledhur, 76 milionë raportohen në nivel projekti. Megjithatë, shumë shoqëri që kanë raportuar si një projekt i vetëm në formularin e Transparencës janë të përfshira në projekte të shumta, sikurse konstatohet në Raportin e EITI-t, gjë që vë në pikëpyetje përqindjen e mbulimit. Komentet e MSG-së përpara validimit shprehin se 16 nga 37 shoqëri raportuese kishin më shumë se një licensë. Për shembull, Beralb Sh.a. (K12107002A) deklaroi në formularin e Transparencës se kishte vetëm një licensë (licensa nr. 643), kur në fakt mban tetë licenca sipas tabelës 44 të raportit të EITI-t, që nuk janë disagreguar më tej.

të Bankës Botërore, i cili mund të vlerësojë gjithashtu se deri në ç' masë licencat dhe kontratat e ndryshme janë “të ndërlidhura në mënyrë të konsiderueshme”.

Së fundi, kur u pyetën rreth sistemeve alternative qeveritare që mund t'i kategorizojnë të dhënat sipas projektit, disa palë interesi qeveritare u shprehën se të gjitha shoqëritë i depozitojnë “formularët e deklarimit” pranë AKBN-së për licensë apo leje individuale, ndonëse kjo gjë mbetet ende për t'u konfirmuar. Edhe pse palët e interesit nga shoqëria civile shprehen pro kësaj praktike, MSG-ja nuk e ka diskutuar asnjëherë mundësinë e përcaktimit të kërkesave të veprimtarive minerare në nivel license ose kontrate.

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave të EITI-t ose masave korrigjuese është mundësuar falë modeleve tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur në shtojcën e këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Publikimi i gjithanshëm i taksave dhe të ardhurave (Kërkesa #4.1)	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për publikime të gjithanshme të pagesave të shoqërive dhe të ardhurave qeveritare nga nafta, gazi dhe minierat, të cilat e ndihmojnë publikun të kuptojë kontributin e industrive nxjerrëse në të ardhurat qeveritare. Niveli i progresit në përbushjen e kësaj kërkesë ka qenë i njëjtë që prej Validimit të fundit, pra nuk ka pasur përmirësime të ndjeshme.</p> <p>Duket se MSG-ja, në përcaktimin e të ardhurave dhe shoqërive materiale, nuk ka bërë progres që prej Validimit të 2019-s kundrejt veprimit korrigjues për të marrë parasysh pragjet e materialitetit për përzgjedhjen e shoqërive minerare. Duket se metodologjia nuk ka ndryshuar që prej Validimit të fundit dhe raporti tregon se nuk janë caktuar pragje për përcaktimin e të ardhurave materiale. Sekretariati Ndërkombëtar nuk mund të arrijë në përfundimin se qeveria shqiptare bën publikime të plota rreth të ardhurave qeveritare nga sektori nxjerrës sipas zërave individualë të të ardhurave. Raporti i EITI-t shprehet se nuk ka publikime të plota nga ana e qeverisë dhe se zërat e të ardhurave të shumta duket se janë përjashtuar pa marrë në konsideratë vlerat e tyre totale individuale. Shoqëritë minerare vijojnë të përzgjidhen në bazë të prodhimit, pa pasur një detajim të kontributit që jep çdo shoqëri në të ardhurat qeveritare, ndjekur nga një konfirmim ex-post për një zë të caktuar të ardhurash. Meqenëse 31 nga 137 shoqëri nuk kanë raportuar, përcaktimi i gjithanshmërisë së raportimit mbetet ende sfidë, së bashku me pasiguritë lidhur me publikimet e të ardhurave nga ana e qeverisë. Së fundi, dy subjekte qeveritare nuk kanë raportuar as në 2017-n, as në 2018-n: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministria e Turizmit dhe mjedisit (MTM).</p>	Përbushur kryesisht (pa përmirësime që prej Validimit të fundit)
Ofrimi i infrastrukturës dhe transaksionet e këmbimit (Kërkesa #4.3)	<p>Sekretariati vlerëson se Kërkesa 4.3 sërish “ka qenë e pazbatueshme” në Shqipëri për periudhën objekt vlerësimi. Niveli i progresit kundrejt plotësimit të kësaj kërkesë vijon të jetë i njëjtë që prej Validimit të fundit, ndonëse MSG-ja këshillohet që ta konfirmojë këtë pazbatueshmëri çdo vit përmes procesit të raportimit të EITI-t.</p>	E pazbatueshme

<p>Të ardhurat nga transporti (Kërkesa #4.4)</p>	<p>Sekretariati vlerëson se Kërkesa 4.4 sërish “ka qenë e pazbatueshme“ në Shqipëri për periudhën objekt vlerësimi. Niveli i progresit kundrejt plotësimi të kësaj kërkesë vijon të jetë i njëjtë që prej Validimit të fundit, ndonëse MSG-ja këshillohet që ta konfirmojë këtë pazbatueshmëri çdo vit përmes procesit të raportimit të EITI-t.</p> <p>Nuk ka NSh ose agjenci qeveritare që merret me rregullimin e transportit të minerareve dhe ndonëse Raporti i EITI-t ka identifikuar disa shoqëri dhe partneritete publik-privat (PPP) në sektorin e depozitim-transportit të naftës dhe gazit, konsultimet me palët e interesit kanë konfirmuar se këto rregullime nuk kanë qenë aktive ose kanë qenë në zhvillim e sipër gjatë periudhës objekt vlerësimi. NSh-ja Transnafta Sh.a. nuk ka qenë aktive gjatë periudhës objekt vlerësimi, ndërsa Albgazi, ndonëse i është nënshtruar tarifave të transportit të gazit nga ERE, nuk ka qenë aktiv gjatë periudhës 2017-2018. PPP-ja me La Petrolifera Italo-Albanese Sh.a. (PIA) dhe përshkrimet e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) tregojnë se qeveria shqiptare nuk ka marrë shpërbllim në vitin 2018.</p>	<p>E pazbatueshme</p>
<p>Niveli i disagregimit (Kërkesa #4.7)</p>	<p>Sekretariati vlerëson paraprakisht se Shqipëria e ka përmbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar disagregimin e publikimeve të pagesave të shoqërive dhe të ardhurave qeveritare nga nafta, gaz dhe minierat, në mënyrë që publiku të vlerësojë se në ç’nivel mund t’i monitorojë qeveria arkëtimet e të ardhurave të veta, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor dhe fiskal, dhe nëse qeveria e merr atë që duhet të marrë nga çdo projekt nxjerrës individual. Niveli i progresit në përmbushjen e kësaj kërkesë ka qenë i njëjtë që prej Validimit të fundit, pra nuk janë përfshirë plotësisht aspektet e reja të kërkesës.</p> <p>Raportimi i EITI-t nxjerr në pah sfidat e konsiderueshme që hasin sistemet qeveritare për të publikuar të dhënat e disagreguara sipas zërit të të ardhurave, shoqërisë dhe subjektit qeveritar, për shkak të problematikave të miratimit paraprak të licensave për publikimin e të dhënave tatimore dhe doganore. Megjithatë, raporti i EITI-t nuk disagregon të dhëna për ato shoqëri që e kanë dhënë miratimin e tyre për këto publikime. Për sa i përket raportimit në nivel projekti (RNP), Shqipëria përdor përkufizim të njëjtë për “projektin“ me standardin e EITI-t; një marrëveshje e vetme për naftën në sektorin e naftës dhe gazit dhe “çdo licensë“ për sektorin minerar. Rentat janë i vetmi zë i të ardhurave që vendosen në nivel projekti. Megjithatë, ka pasur sfida të konsiderueshme lidhur me RNP-në për shkak të shoqërive minerare që zotërojnë shumë licensa, ndonëse sistemet qeveritare i regjistrojnë vetëm për numër unik të identifikimit të shoqërisë. Konsultimet me palët e interesit treguan se AKBN-ja ose agjencitë e tjera përveç Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, marrin deklarata të rregullta nga titullarët e licensave/konsecioneve/kontratave në nivel projekti, gjë që mund të zbulojë potencialin për raportim në nivel projekti përmes sistemeve qeveritare. Pavarësisht kësaj, Albeiti ka kërkuar të mbledhë të dhëna RNP nga shoqëritë për ta kapërcyer këtë sfidë, ku ka shënuar sukses të pjesshëm. Të dhënat e ofruara deri më tani përmes formularëve të Validimit dhe në raportin e EITI-t 2017-2018 tregojnë se Shqipëria i raporton të dhënat për projekt në mënyrë të gjithanshme, në përputhje me Kërkesën 4.7 të Standardit të EITI-t.</p>	<p>Përmbushur kryesisht</p>

<p>Përshtatshmëria kohore e të dhënave (Kërkesa #4.8)</p>	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar publikimin në kohë të pagesave të shoqërive dhe të ardhurave qeveritare nga nafta, gazi dhe minierat, në mënyrë që të përdoren në debate publike dhe politikëbërje. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 4.8, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”.</p>	<p>Përmbushur plotësisht</p>
<p>Cilësia dhe sigurimi i të dhënave (Kërkesa #4.9)</p>	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për marrjen e masave të përshtatshme për të siguruar besueshmërinë e publikimit të pagesave të shoqërive dhe të ardhurave qeveritare nga nafta, gazi dhe minierat. Qëllimi është që EITI të kontribuojë në përmirësimin e auditimeve rutinë të qeverisë dhe shoqërive, në forcimin e sistemeve dhe praktikave të sigurimit të cilësisë, si dhe të sigurohet që palët e interesit të kenë besim të saktësia e të dhënave financiare për pagesat dhe të ardhurat. Niveli i progresit në përmbushjen e kësaj kërkesë ka qenë i njëjtë që prej Validimit të fundit, pra nuk ka pasur përmirësime të ndjeshme.</p> <p>Procedurat statutores të auditimit në Raportin e EITI-t janë më se të qarta. Megjithatë, në vitin 2018, asnjë subjekt qeveritar ose ndërmarrje shtetërore (NSH) nuk ia ka dorëzuar pasqyrat ose raportet e audituara financiare Administratorit të Pavarur (AP) dhe vetëm 25 shoqëri i kanë publikuar rezultatet e auditimit të jashtëm, pa e detajuar informacionin sipas shoqërisë raportuese. Raporti tregon se në vitin 2018 janë audituar vetëm 45% e të ardhurave të rakorduara (42% gaz dhe naftë, 8% miniera dhe 89% hidroenergji). Për më tepër, raporti nxjerr në pah se MSG-ja nuk ka e ka ndryshuar metodën e vlerësimit të sigurisë së cilësisë lidhur me procesin e raportimit 2017-2018 dhe pretendon se është ndjekur Standardi TeR për AP-të. Raporti i EITI-t nuk qartëson se si ka ndikuar MSG-ja në hartimin e formularëve të raportimit, duke cituar një formular të vjetruar të 2011-s, bashkëlidhur një formular për pronarët përfitues (shihni Kërkesën 2.5). Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit duket se japin shembuj të mënyrës se si diskutohet dhe vendoset raportimi nga MSG, duke paraqitur programin e detajuar të mbledhjeve të MSG për datën 27 korrik 2021. Programi i mbledhjes dhe komentet e MSG sqarojnë se këto çështje janë duke u diskutuar, edhe pse MSG nuk ka arritur në një vendim të qartë lidhur me garancitë shtesë dhe/ose modelet e raportimit. Rezultati i këtyre diskutimeve duhet të rivlerësohet në Validimet e ardhshme.</p> <p>Raporti i EITI-t paraqet vlerësime të shumta dhe kontradiktore të gjithanshmërisë dhe nuk arrin në asnjë përfundim të qartë lidhur me besueshmërinë e të dhënave të EITI-t. Edhe në rastin e kufizimeve më lart, sërish këndvështrimi i MSG-së për gjithanshmërinë e Raportit të EITI-t mbetet i pandryshuar. Vlerësimet janë bërë për zë individual të ardhurash, edhe pse bien ndesh me kufizime të tjera për të ardhurat nxjerrëse totale (shihni Kërkesën 4.1). Së fundi, kufizimet lidhur me verifikimet ex-post të përzgjedhjes së shoqërive zbulojnë se gjithanshmëria vlerësohet vetëm kundrejt një zëri të ardhurash, dhe jo kundrejt të ardhurave totale.</p>	<p>Përmbushur kryesisht (pa përmirësime që prej Validimit të fundit)</p>
<p>Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet</p>		
<ul style="list-style-type: none"> Në përputhje me Kërkesën 1.4.d, Shqipëria duhet të sigurohet që qeveria të japë informacion të agreguar rreth shumës së të ardhurave totale të përfuara nga çdo zë në kuadër të zbatimit të EITI-t, përfshi edhe të ardhurat që janë nën pragjet e dakordësuara të materialitetit. Për më tepër, në përputhje me Kërkesat 4.1.b dhe 4.1.d, pragu i materialitetit për shoqëritë e përzgjedhura në raportimin e ardhshëm të EITI-t garanton që të gjitha pagesat të 		

cilat mund të ndikojnë gjithanshmërinë e raportimit të EITI-t të përfshihen në objektin e rakordimit, dhe të sigurohet që të gjitha shoqëritë materiale të marrin pjesë në raportimin e EITI-t. Shqipëria mund të marrë në konsideratë rishikimin e pragut të materialitetit për shoqëritë minerare të përzgjedhura, për të vendosur ekuilibrin midis gjithanshmërisë së publikimeve dhe cilësisë së raportimit. MSG-ja mund të marrë në konsideratë një qasje kampionimi që do të lejonte hetimin e këtyre pagesave pa krijuar barrë të panevojshme raportimi. Në plan afatgjatë, Shqipëria mund të kërkojë ndryshime ligjore përmes amendamenteve ose legjislacionit të ri që mund të zgjidhë çështjet e konfidencialitetit tatimor. Një tjetër mundësi është që Shqipëria t'u kërkojë shoqërive nxjerrëse heqje dorë shumëvjeçare për të siguruar publikim të plotë nga ana e qeverisë të të ardhurave që kjo e fundit merr nga shoqëritë e përfshira në veprimtaritë nxjerrëse.

- Për t'i vlerësuar më me efikasitet të ardhurat e plota qeveritare nga shoqëritë nxjerrëse, dhe për të kapërcyer barrierat praktike të llogaritjes, Albeiti mund të përdorë një qasje të dyfishtë për llogaritjen, duke krahasuar të ardhurat totale të marra nga shoqëritë nxjerrëse të regjistruara me veprimtaritë e tyre kryesore në "B. Minierat dhe guroret (përfshi naftën)", sipas standardit ISIC të Kombeve të Bashkuara për të dhënat, kundrejt të ardhurave të gjeneruara nga titullarët e të drejtave të shfrytëzimit, minierave dhe naftës.
- Për të siguruar përmbushjen e Kërkesave EITI, Shqipëria nxitet të sigurojë që, për të përcaktuar nëse të dhënat nga periudha e raportimit janë të zbatueshme apo jo, të përdoren vetëm të dhënat e raportuara gjatë periudhës së raportimit në fjalë dhe të mos citohen si prova Validimet ose Raportet e mëparshme të EITI-t. Duke marrë veçanërisht parasysh rritjen e rëndësisë së të ardhurave nga transporti i gazit përmes vendit, Albeiti mund të mbështetet te vlerësimet e materialitetit për t'u siguruar nëse këto kërkesa janë të zbatueshme apo jo.
- Në përputhje me Kërkesën 4.7, Shqipëria duhet të vijojë ta përmirësojë mbulimin e të ardhurave për projekt (licensa, kontrata dhe koncesione). Shqipëria duhet të sigurojë identifikimin e çdo marrëveshje të ndërlidhur ose çdo marrëveshjeje të përgjithshme dhe lidhjen midis të dhënave përkatëse për çdo shoqëri dhe projekteve individuale si për shoqëritë e minierave, ashtu edhe për ato të naftës. Për të përmirësuar më tej sistemet e qeverisë shqiptare dhe aftësinë e tyre për të monitoruar pagesat sipas licensës, Albeiti nxitet të angazhojë subjektet qeveritare vendore ose rajonale për të parë nëse rentat po regjistrohen apo nëse rentat mund të regjistrohen si pjesë e deklarimeve të rregullta të subjekteve tregtare kundrejt qeverisë, të cilat bëhen për çdo licensë. Për këtë duhet parë nëse nevojiten ndryshime në ligje ose instrumente statutoare apo rregullore, duke u siguruar që këto ndryshime të jenë efikase për kostot.
- Për ta përmirësuar zbatimin dhe kontributin e të dhënave të EITI-t në debate publike, Shqipëria nxitet të përmirësojë përshtatshmërinë kohore të të dhënave EITI (Kërkesa 4.8), duke u mbështetur te publikimet sistematike ekzistuese nga shoqëritë dhe qeveria, me shumë mundësi duke i kombinuar me kuadro alternative dhe fleksible raportimi.
- Në përputhje me Kërkesën 4.9.a, EITI kërkon të ndërmerret një vlerësim për të parë nëse pagesat dhe të ardhurat janë subjekt i auditimeve të besueshme dhe të pavarura, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Në përputhje me Termat standarde të Referencës për AP-në të miratuara nga Bordi i EITI-t, Shqipëria duhet të zhvillojë dhe të miratojë procedurat e sigurimit të cilësisë për raportimin e EITI-t, bazuar në rishikimin e auditimit dhe praktikën e sigurimit të cilësisë gjatë vitit objekt vlerësimi. Shqipëria duhet të sigurojë që Raporti i EITI-t të përfshijë edhe një vlerësim që përcakton nëse shoqëritë dhe subjektet qeveritare që janë objekt i procesit të raportimit të EITI-t i kanë ofruar të gjitha informacionet e kërkuara. Çdo boshllëk ose dobësi në raportimin e AP-së duhet publikuar në Raportin e EITI-t, përfshi edhe identitetin e subjekteve që nuk i kanë respektuar procedurat e miratuara dhe vlerësimin nëse mosveprimet e subjektit mund të ndikojnë në gjithanshmërinë dhe besueshmërinë e raportit. Shqipëria duhet të sigurohet që AP-ja të ndërmarrë një vlerësim të gjithanshmërisë dhe besueshmërisë së të dhënave (financiare) të paraqitura, përfshi edhe përmbledhjen informuese rreth punës së AP-së dhe kufizimeve të vlerësimit të ndërmarrë. Gjatë zbatimit të verifikimit ex-post të përzgjedhjes së shoqërive, Albeiti duhet të sigurojë që mosveprimet të krahasohem me të gjitha të ardhurat materiale dhe jo vetëm me një apo dy zëra të ardhurash.

Menaxhimi i të ardhurave (Kërkesat 5.1, 5.3)

Tabloja e progresit në modul

Shqipëria e ka përmbushur objektivin e sigurimit të gjurmueshmërisë së të ardhurave, si për ato brenda, ashtu edhe ato jashtë buxhetit. Shqipëria ka siguruar edhe mbikëqyrjen e menaxhimit të të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse, si dhe përdorimin e të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse për të financuar shpenzime të caktuara publike dhe parashikimet e procesit buxhetor. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me përmbushjen e kërkesave të menaxhimit të të ardhurave. Megjithatë, ky Validim nuk ka gjetur as prova që të tregojnë se Kërkesa 5.3 për menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të jetë “tejpërmbushur”, ndaj shënohet si e “pavlerësuar”.

Për sa i përket publikimit të shpërndarjes së të ardhurave nga industritë nxjerrëse, Raporti i EITI-t 2017-2018 për Shqipërinë përshkruan qartësisht se si regjistrohen të ardhurat nga minierat në buxhetin kombëtar. Teksa shumica e të ardhurave nga nafta dhe gazi janë të regjistruara në buxhetin kombëtar, të ardhurat jashtë buxheti në sektorin e naftës dhe gazit i shkojnë Albpetrolit dhe AKBN-së. Publikimi i rregullt dhe transparent i pasqyrave financiare të Albpetrolit do të thotë se edhe të ardhurat jashtë buxheti nga nafta dhe gazi trajtohen me nivel mjaft të lartë transparence. Ndonëse AKBN-ja nuk i publikon pasqyrat e saj financiare, Raporti i EITI-t 2017-2018 për Shqipërinë përmban edhe një përshkrim se si përdoret përqindja e vogël e të ardhurave.

Albeiti ka forcuar mbikëqyrjen publike duke sqaruar se të ardhurat nga veprimtaria nxjerrëse në Shqipëri nuk caktohen në mënyrë të dedikuar për shpenzime jashtë proceseve buxhetore kombëtare. Raporti 2017-2018 i EITI-t hedh dritë edhe mbi procesin e auditimit, përfshi standardet dhe lidhjet midis publikimit të auditimit të përputhshmërisë dhe performancës me objekt subjektet qeveritare. Për më tepër, informacioni për buxhetin dhe shpenzimet e shtetit publikohet sistematikisht në faqen e internetit të Ministrisë së Financave.⁴⁶

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave të EITI-t ose masave korrigjuese është mundësuar falë modeleve tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur në shtojcën e këtij raporti.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
Shpërndarja e të ardhurave nga industria nxjerrëse (Kërkesa #5.1)	Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur plotësisht objektivin e kësaj kërkesë për të siguruar gjurmueshmërinë e të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse në buxhetin kombëtar dhe për të siguruar të njëjtin nivel transparence dhe llogaridhënieje për të ardhurat nga veprimtaria nxjerrëse që nuk janë të regjistruara në buxhetin kombëtar. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 5.1, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”. Të gjitha të ardhurat e Shqipërisë nga minierat janë të regjistruara në buxhetin kombëtar, krahas 72% të të ardhurave nga nafta dhe gazi. Zërat e të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse që nuk janë të regjistruara në buxhetin kombëtar përbëhen	Përmbushur plotësisht

⁴⁶Financat Vendore (2021), “Platforma e Financave Vendore”. I disponueshëm në:

<http://financatvendore.al/>

	kryesisht nga përqindja e Shqipërisë së prodhimit të naftës dhe bonuset që merren nga Albpetroli, për të cilat pasqyrat financiare janë të disponueshme online. Raporti konstaton se AKBN-ja është një prej agjencive që ka mbledhur dhe mbajtur një përqindje të vogël të të ardhurave nga nafta dhe gazi në vitin 2018 (bonuse).	
Menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimet (Kërkesa #5.3)	Progresi kundrejt përmbushjes së Kërkesës 5.3 nuk vlerësohet në Validim, përveç se kur ka prova që vendi e ka tejpermbushur kërkesën. Sekretariati vlerëson se Albeiti e ka përmbushur objektivin e kësaj kërkesë për të forcuar mbikëqyrjen publike të menaxhimit të të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse, si dhe përdorimin e të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse për të financuar shpenzime të caktuara publike dhe parashikimet e procesit buxhetor. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 5.3, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me “progres të kënaqshëm”.	Pa vlerësuar
Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet		
<ul style="list-style-type: none"> Për të përmirësuar zbatimin e Kërkesave 5.1 dhe 5.3, Shqipëria mund të përdorë raportimin e EITI-t për t’iu referuar pasqyrave financiare të Albpetrolit të publikuara sistematikisht dhe mund të mbështesë AKBN-në⁴⁷ për të shtuar nga një nivel llogaridhënieje dhe sigurie çdo vit lidhur me të ardhurat jashtë buxhetit të Shqipërisë. Shqipëria mund të përdorë raportimin e EITI-t për të bërë diagnostikimin vjetor të reformave qeveritare të të ardhurave jashtë buxheti, me qëllim forcimin e llogaridhënies publike në reformimin e agjencive të tilla si AKBN-ja. Së fundi, Shqipëria rekomandohet ta përdorë procesin e EITI-t për t’u siguruar që parashikimet dhe shpenzimet të përshtaten në mënyrë të tillë që të ofrojnë përlllogaritje realiste të të ardhurave të ardhshme dhe aftësisë së këtyre të ardhurave për të mbuluar shpenzimet e vendit në plan afatmesëm dhe afatgjatë. Për të përmirësuar zbatimin, Shqipëria mund të përdorë raportimin e saj EITI si mjet për të siguruar zbulimin qeveritar në kohë, i cili do të ndihmonte në mirëkuptimin e mëtejshëm të publikut dhe në debatin lidhur me çështjet e qëndrueshmërisë së të ardhurave dhe vartësinë nga burimet, duke përfshirë supozimet që mbështetin vitet e ardhshme në ciklin buxhetor dhe në lidhje me prodhimin e parashikuar, çmimet e mallrave dhe parashikimet e të ardhurave që ëlindin nga industrinë e gjermimit dhe proporcioni i të ardhurave fiskale të ardhshme që pritet të vijnë nga sektori i gjermimit. Ky raportim EITI mund të përmirësojë më tej kontributin EITI të Shqipërisë në debatin publik lidhur me ndikimin e tranzicionit energjetik në industrinë e gjermimit. 		

Kontributi nënkombëtar (Kërkesat 4.6, 5.2, 6.1)

Tabloja e progresit në modul

Shqipëria vijon ta përmbushë objektivin e përgjithshëm të raportimit për transfertat nënkombëtare të të ardhurave të saj në kuadër të Kërkesës 5.2. Është shënuar po i njëjti progres që prej Validimit të fundit. Janë përzgjedhur gjashtë njësi të qeverisjes vendore (NjQV) për raportimin dhe rakordimin e transfertave nënkombëtare të rentave në Shqipëri, të cilat së bashku përbëjnë 84% të të gjitha këtyre transfertave. 55 NjQV-të e mbetura përbëjnë 16%-shin e mbetur. Pavarësisht boshllëqeve të vogla si mospublikimi i transfertave të buxhetuara për NjQV-në, është përmbushur objektivi i përgjithshëm për të përcaktuar nëse transfertat dhe menaxhimi i transfertave nënkombëtare të të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse janë në përputhje me parashikimet statutoare. Raporti i EITI-t për Shqipërinë 2017-2018 përshkruan transfertat nënkombëtare statutoare të rentave, paraqet formulën e përgjithshme, e zbaton këtë formulë për pagesat e rentave të vitit 2017 dhe 2018, si dhe përfshin transfertat e buxhetuara dhe faktike të

⁴⁷ Albpetroli (2021), “Rezultatet Financiare të Albpetroli-it”. Të disponueshme në: <https://albpetroli.al/njoftim-per-qytetaret/>

2017-s dhe 2018-s në mënyrë të agreguar, megjithëse komentet e MSG-së sqaruan gjithashtu se transfertat e buxhetuara dhe aktuale nuk mund të bashkërendohen për shkak të kriterëve formale si pjesë e procesit të disbursimit. Pra e thënë shkurt, mund të ketë shumë arsye pse një sasi e disbursuar realisht mund të ndryshojë nga ajo që është buxhetuar që më përpara. Raporti shpjegon edhe arsyet e mundshme të mospërputhjeve midis transfertave të buxhetuara dhe transfertave faktike. Raporti përcakton edhe transfertat faktike të kryera në vitin 2017 dhe 2018 për të gjashtë NjQV-të raportuese, të disagreguara sipas NjQV-ve, dhe rakordon të dhënat e raportuara nga këto NjQV dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Megjithatë, Albeiti vijon të përballet me disa boshllëqe për sa i përket raportimit të pagesave nënkombëtare direkte nga shoqëritë nxjerrëse në përputhje me Kërkesën 4.6. Mbulimi i të ardhurave të NjQV-së varet nga aftësia e sistemeve për të përcaktuar se cilat janë totalët e vërteta tatimore dhe jotatimore, çështje kjo që zakonisht mbulohet nga Kërkesa 4.1.⁴⁸ Ka pak prova që tregojnë se ka pasur përmirësim të publikimeve të pagesave nënkombëtare që prej Validimit të fundit. Vijon të mbetet e paqartë se si janë përzgjedhur këto gjashtë NjQV-të si material për raportimin e pagesave nënkombëtare, për shkak të mungesës së vlerësimit të materialitetit të të ardhurave të mbledhura nga çdo NjQV. Dokumentet publike nuk japin arsye të qarta se përse janë përzgjedhur po të njëjtat NjQV për të raportuar rreth pagesave nënkombëtare direkte dhe pagesave nënkombëtare, për shkak të mungesës së provave të lidhjes që ekziston midis pagesave nënkombëtare direkte të shoqërive nxjerrëse dhe transfertave nënkombëtare të të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse. Për më tepër, edhe ato gjashtë NjQV që u përzgjedhën raportuan me vonesë, me pasaktësi dhe në çdo rast në mënyrë të pjesshme.⁴⁹ Kështu, Sekretariati vlerëson se nuk janë përmbushur aspekte të rëndësishme të veprimit korrigjues që prej Validimit të fundit.

Siç është dokumentuar fare qartë në planin e punës dhe studimet e Albeiti-t, ndikimet dhe përfitimet sociale dhe mjedisore të komuniteteve vendore janë mjaft me interes për Shqipërinë. Megjithatë, Sekretariati ka konstatuar se ende nuk është përmbushur objektivi i përgjithshëm për të qartësuar kontributet mjedisore dhe bazën e vlerësimit të përputhshmërisë së shoqërive me detyrimet ligjore dhe kontraktuale për kryerjen e shpenzimeve mjedisore. Sipas raporte të EITI-t, materialiteti i pagesave mjedisore nga shoqëritë nxjerrëse nuk është vlerësuar në mënyrë të gjithanshme, të paktën deri më sot. Palët e konsultuara të interesit zbuluan se disa pagesa mjedisore të shoqërive minerare në fazën e eksplorimit mund të jenë mjaft të konsiderueshme. Ndonëse Raporti i EITI-t 2017-2018 ka publikuar taksën e karbonit për sektorin e naftës, gazit dhe minierave, MSG-ja nuk është shprehur nëse e ka marrë parasysh taksën e karbonit si pagesë mjedisore, dhe Raporti i EITI-t nuk raporton në mënyrë të gjithanshme se sa taksa karboni ka marrë Shqipëria nga të gjitha shoqëritë që ushtrojnë veprimtari nxjerrëse.

Progresi sipas kërkesave dhe veprimeve korrigjuese

Vlerësimi i detajuar i progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave të EITI-t ose masave korrigjuese është mundësuar falë modeleve tip të mbledhjes së të dhënave bashkëlidhur në shtojcën e këtij raporti.

⁴⁸ Nëse e marrim të mirëqenë se tabela 37 është totali i vërtetë i të gjitha pagesave që shoqëritë nxjerrëse i kanë bërë NjQV-ve, atëherë rakordimi është (tabelat 50,54,58) afro 97.5%. Megjithatë, nëse tabelat 39,41,4 paraqesin totalin më të përafërt të arkëtimit të NjQV-ve, atëherë niveli i rakordimit bie në 33%.

⁴⁹ Shihni faqen 187 të Raportit të EITI-t 2017-2018.

Kërkesat EITI	Përmbledhja e progresit kundrejt përmbushjes së Kërkesave EITI	Vlerësimi i sekretariatit
<p>Pagesat nënkombëtare (Kërkesa #4.6)</p>	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për t'i ndihmuar palët e interesit t'i kuptojnë më mirë përfitimet e qeverive vendore nëpërmjet transparencës së pagesave direkte nga shoqëritë në favor të subjekteve nënkombëtare dhe forcimit të mbikëqyrjes publike të menaxhimit të të ardhurave të qeverive nënkombëtare nga veprimtaria nxjerrëse. Shqipëria shprehet se gjashtë NjQV raportuese ishin materiale, bazuar te prodhimi dhe transfertat nënkombëtare të rentës. Megjithatë, disa pagesa nënkombëtare në favor të NjQV-ve janë raportuar në "Pagesa të tjera për NjQV-në", dhe jo për zë të ardhurash. Këto raportime janë të pjesëshme, të vonuara dhe me pasaktësi (Raporti i EITI-t për Shqipërinë 2017-2018, f.186-187). Raporti i EITI-t (f.152) si dhe MSG-ja e Albeiti-t konfirmuan se pjesa më e madhe e pagesave që i bëhen NjQV-ve janë taksa vendore që nuk lidhen me sektorin nxjerrës. Prapëseprapë, Shqipëria nuk ka bërë progres kundrejt zbatimit të veprimit korrigjues së Bordit të EITI-t, i cili përcakton se MSG-ja duhet t'i shënjestrojë si duhet pagesat nënkombëtare direkte të shoqërive nxjerrëse në favor të NjQV-ve, për të përcaktuar bazën e diskutimeve për materialitetin e MSG-së lidhur me pagesat direkte që i bëhen NjQV-ve. Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit sqarojnë ligjin e saktë i cili u jep NjQV-ve mandatin për të vendosur taksa dhe tarifa vendore (shiko modelin Transparenca të bashkëngjitur në këtë raport Validimi), edhe pse nuk sqaron vlerën e çdo të ardhure të NjQV-ve në përputhje me ligjin në periudhën që është nën shqyrtim. Edhe rekomandimet e tjera për Kërkesën 4.6 nuk janë përmbushur, të cilat përcaktojnë se pagesat e industrive nxjerrëse në favor të njësisve të qeverisjes vendore, kur janë materiale, duhen publikuar dhe rakorduar, si dhe për të gjitha pagesat vendore duhet publikuar një lloj shpjegimi i detajuar. Skenari aktual na bën të vëmë në pikëpyetje gjithanshmërinë e raportimit të pagesave nënkombëtare direkte në Shqipëri.</p>	<p>Përmbushur kryesisht (pa përmirësime që prej Validimit të fundit)</p>
<p>Transfertat nënkombëtare (Kërkesa #5.2)</p>	<p>Sekretariati vlerëson se Albeiti e ka përmbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për t'u dhënë mundësinë palëve vendore të interesit të vlerësojnë nëse transfertat ose menaxhimi i transfertave të të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse janë në përputhje me parashikimet statutoare. Nuk ka prova që të tregojnë se ka pasur regres lidhur me Kërkesën 5.2, e cila u vlerësua në Validimin e mëparshëm me "progres të kënaqshëm". Ndonëse 5%-shi i rentës u shpërndahet NjQV-ve nga Drejtoria e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, transfertat faktike ekzekutohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet sistemit të vetëm të thesarit të qeverisë. Raporti i EITI-t për Shqipërinë 2017-2018 përshkruan transfertat nënkombëtare statutoare të rentave, paraqet formulën e përgjithshme, si dhe përfshin transfertat e buxhetuara dhe faktike të 2017-s dhe 2018-s. Megjithatë, Albeiti nuk i ka kategorizuar transfertat nënkombëtare buxhetore sipas NjQ-ve, dhe as nuk ka bërë krahasimin e llogaritjes së 5%-shit të rentës që duhet të ishte shpërndarë për NjQV. Kjo pengon vlerësimin e mospërputhjeve midis shumës së buxhetuar dhe shumës faktike të transferuar, të disagreguara sipas NjQV-ve. Ky progres është vlerësuar nga Bordi i EITI-t si i mjaftueshëm në Validimin e fundit, dhe duket se progresi i Shqipërisë në këtë drejtim vijon të mbetet i njëjtë. Përveç kësaj, si pjesë e komenteve të MSG-së për draft-raportin e Validimit, një zhvillim i fundit i vitit 2021 është hapja e një llogarie të dedikuar në Sistemin e Unifikuar të Thesarit: 7204100 "Grantet e njësisë vendore nga pjesëmarrja në taksën e rentës minerare". Edhe pse komentet nuk ndikojnë në vlerësimin e plotësimin të plotë, ato tregojnë se sistemet e qeverisë do të rritin</p>	<p>Përmbushur plotësisht</p>

	më tej të ardhurat e saj të monitorimit, të cilat janë të destinuara për transfertat nënkombëtare nga renta minerare të mbledhura në vitin 2022 e në vazhdim.	
Shpenzimet sociale dhe mjedisore (Kërkesa #6.1)	<p>Sekretariati vlerëson se Shqipëria e ka përmbushur kryesisht objektivin e kësaj kërkesë për ta ndihmuar publikun të kuptojë kontributet sociale dhe mjedisore të shoqërive nxjerrëse dhe për të përcaktuar bazën e vlerësimit të përputhshmërisë së shoqërive nxjerrëse me detyrimet ligjore dhe kontraktuale lidhur me kryerjen e shpenzimeve sociale dhe mjedisore. Niveli i progresit në përmbushjen e kësaj kërkesë ka qenë i njëjtë që prej Validimit të fundit, pra nuk janë përfshirë plotësisht aspektet e reja të kërkesës.</p> <p>Pagesat sociale në Shqipëri nuk janë të detyrueshme, por Standardi EITI 2019 ka mbuluar edhe pagesat mjedisore në favor të qeverisë. Pagesat mjedisore kërkohen me ligj dhe sipas Raportit të EITI-t 2017-2018 bëhen në favor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe klasifikohen si shpenzime sociale/mjedisore. Prandaj, pagesat sociale duhen përjashtuar nga raportimi, ndërsa materialiteti i pagesave mjedisore duhet vlerësuar. Pagesat e agreguara mjedisore për zë të ardhurash për të gjithë sektorët (dhe jo vetëm për industrinë nxjerrëse) janë publikuar online nga Albeiti dhe i gjeni në: http://www.instat.gov.al/en/themes/environment-and-energy/environmental-accounts/. Për vitin 2018 objekt vlerësimi, këto pagesa ishin 51,146 milionë lekë. Shuma totale i tejkalon pragjet e materialitetit të përcaktuara nga Albeiti për raportimin e zërave të të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse. Ndonëse mbetet ende e paqartë se sa prej këtyre pagesave mjedisore i atribuohen industrive nxjerrëse, gjasat janë që të jenë materiale. Megjithatë, MSG-ja e Albeiti-t nuk e ka diskutuar materialitetin e këtyre pagesave. Fakti se totali i të ardhurave qeveritare nuk është publikuar në përputhje me Kërkesën 4.1 e vështirëson më tepër këtë llogaritje.</p> <p>Konsultimet me palët e interesit gjatë validimit zbuluan se disa prej këtyre pagesave mjedisore mund të jenë të konsiderueshme për shoqëritë minerare eksploruese. Tjetër shembull për t'u marrë: Raporti i EITI-t për Shqipërinë 2017-2018 ka publikuar taksën e karbonit për sektorin e naftës, gazit dhe minierarave (tabelat 14 dhe 23), por ka përmendur edhe akcizën (shihni edhe: Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara (UNECE), vlerësimi i tretë i performancës mjedisore të Shqipërisë, f.37). MSG-ja e Albeiti-t nuk është shprehur nëse e ka konsideruar taksën e karbonit apo pagesa të tjera mjedisore si pagesa mjedisore <i>materiale</i>. Komentet e MSG-së për draft-raportin e Validimit konfirmuan se ka pagesa mjedisore të detyrueshme që duhen paguar nga kompanitë e gërmimit, megjithëse lloji i saktë i taksës dhe mënyra e llogaritjes mbeten të paqarta.</p>	Përmbushur kryesisht
Masat e reja korrigjuese dhe rekomandimet		
<ul style="list-style-type: none"> Në përputhje me Kërkesën 4.6, Shqipëria duhet t'i shënjestrojë si duhet pagesat nënkombëtare direkte të shoqërive nxjerrëse në favor të NjQV-ve, për të përcaktuar bazën e përgjithshme të diskutimeve për materialitetin e pagesave direkte që i bëhen NjQV-ve. Shqipërisë i kërkohet që të sigurojë publikimin dhe rakordimin e të gjitha pagesave të shoqërive në favor të subjekteve qeveritare nënkombëtare, kur janë materiale, dhe nxitet të përcaktojë se cilat taksa vendore mblidhen nga njësitë e qeverisjes vendore dhe paguhen nga shoqëritë nxjerrëse. Në rast se MSG-ja dëshiron të vijojë ta përdorë gjenerimin dhe transferimin e rentave si vlerë të përfaqësueshme për llogaritjen e materialitetit të pagesave nënkombëtare direkte, ka shumë rëndësi që fillimisht të qartësojë lidhjen midis këtyre transfertave nënkombëtare dhe pagesave nënkombëtare direkte, për shembull nëpërmjet ligjeve të zbatueshme dhe rregullave. Për ta përmirësuar zbatimin e Kërkesës 5.2, në raportimin e EITI-t Shqipëria duhet të bëjë dallimin midis të ardhurave që <i>duhen</i> transferuar në nivel nënkombëtar, të ardhurave që janë buxhetuar <i>faktikisht</i> për këto 		

transferta dhe transfertave *faktike* që janë bërë. Disagregimi dhe publikimi i këtyre të dhënave për NjQV do ta mundësonte Albeiti-n që të jepte informacione më të mira për dialogun e vazhdueshëm në vend lidhur me të ardhurat nënkombëtare që vijnë nga industritë nxjerrëse. Aktualisht, Albeiti publikon të ardhurat që *duhen* transferuar në nivel nënkombëtar dhe *transfertat faktike* që janë bërë për të gjitha NjQV-të, të agreguara. Kjo gjë nuk na lejon të vlerësojmë si duhet shumatat që duhet të marrë çdo NjQV sipas formulës, nëse procesi i buxhetimit ishte i saktë apo jo dhe nëse NjQV-ja e ka marrë faktikisht shumën e buxhetuar. Zbatimi i këtij rekomandimi strategjik, do ta ndihmonte Albeiti-n t'i informonte më mirë palët e interesit nëse NjQV-të po marrin shumatat e duhura të të ardhurave nga veprimtaria nxjerrëse nëpërmjet mekanizmave brendaqeveritare të transferimit.

- Në përputhje me Kërkesën 6.1.b, Shqipëria duhet të vlerësojë materialitetin e pagesave mjedisore të detyrueshme për shoqëritë nxjerrëse në Shqipëri, si pjesë e raportimit të EITI-t. Kur janë materiale, këto pagesa duhen publikuar. Shqipërisë i kërkohet të miratojë procedurën për cilësinë dhe sigurimin e cilësisë së të dhënave për shpenzimet mjedisore, në përputhje me Kërkesën 4.9. Kur rakordimi nuk është i mundur, EITI në Shqipëri duhet të ofrojë publikime të njëanshme të shoqërisë dhe/ose qeverisë për shpenzimet mjedisore.

Sfondi

Tabloja e industrive nxjerrëse

Tablonë e industrive nxjerrëse e gjeni në [në faqen e internetit të EITI-t](#) në Shqipëri.

Historiku i zbatimit të EITI-t

Historikun e zbatimit e gjeni në [në faqen e internetit të EITI-t](#) në Shqipëri.

Shpjegimi i procesit të Validimit

Tablonë e procesit të Validimit e gjeni në faqen e internetit të EITI-t ⁵⁰ [Udhëzuesi i Validimit](#) jep orientime të qarta rreth vlerësimit të Kërkesave EITI, ndërsa procedura më [e detajuar e Validimit](#) përfshin procedurën e standardizuar për realizimin e Validimit nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-t.

Ekipi për mbështetjen e zbatimit të Sekretariatit Ndërkombëtar përbëhet nga Mark Burnett dhe Olesia Tolochko, ndërsa ekipi i Validimit përbëhet nga Christoffer Claussen, Hugo Paret dhe Sridar Kannan.

Konfidencialiteti

Formularët për mbledhjen dhe vlerësimin e detajuar të të dhënave janë të aksesueshme publikisht në faqen e internetit të Komitetit të Validimit [këtu](#).

Praktika që ndiqet lidhur me komentet e palëve të interesit në raportet e Validimit të EITI-t është se emri i palës së interesit apo organizatës mbetet anonim. Konfidencialiteti i identitetit të palëve të interesit respektohet kur kërkohet dhe nuk bëhet e ditur përkatësia e komenteve.

Kohështrirja e Validimit

Validimi për Shqipërinë filloi më 1 tetor 2021. Më 1 shtator filluan mbledhjet publike për të ditur këndvështrimet e palëve të interesit. Konsultimet me palët e interesit u mbajtën virtualisht nga 13 deri më 15 tetor 2021. Projektraporti i Validimit u përmbyll më 18 nëntor 2021. Pas komenteve të MSG-së më 31 dhjetor 2021, raporti i Validimit u finalizua për t'u marrë në shqyrtim nga Bordi EITI.

⁵⁰ Shihni <https://eiti.org/validation>

Burimet

- Dosja e mbledhjes së të dhënave për Validimin – [Angazhimi i palëve të interesit](#)
- Dosja e mbledhjes së të dhënave për Validimin – [Transparenca](#)
- Dosja e mbledhjes së të dhënave për Validimin – [Rezultatet dhe ndikimi](#)
- [Dosja e Validimit për Shqipërinë](#)

Shtojca A: Shqyrtimi i Pronarëve Përfitues në qendrën Kombëtare të Biznesit

Shoqëria dhe NUIS	Sektor i	Të ardhurat e publikuara (në dollarë amerikanë)	Publikimi i të dhënave për pronarët përfitues?	Komente
Bankers Petroleum Albania Ltd. (K43128401L)	Naftë dhe gaz	45,091,865.80	i pjesshëm	Regjistri i PP-ve tregon vetëm emrin e një prej përfaqësuesve ligjore të huaj dhe shtatë numra të tjera identifikues. Megjithatë, regjistri nuk tregon emrin, përqindjet e pronësisë, mënyrën e kontrollit dhe as se cili lloj subjekti ka pronësi ligjore indirekte. Regjistri nuk tregon nëse shoqëria është e listuar publikisht në bursën e ndonjë vendi tjetër, por për pronarët ligjorë jep emrin e subjektit tregtar (fusha 13-18).
Albpetrol Sh.a. (J82916500U)	Naftë dhe gaz	18,920,369.30	Jo	Nuk gjendet në Regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit për Pronarët Përfitues. Ndërmarrjeve shtetërore nuk u kërkohet t'i bëjnë publikë pronarët përfitues. Përfshihen pronarët ligjorë dhe shumat. Raporti EITI dhe komentet e MGS konfirmojnë pronësinë 100% të qeverisë shqiptare, edhe pse nuk duket se ky informacion nuk është sqaruar si pjesë e të dhënave BO të regjistrit.
Albchrome (K11613001M)	Minierat	7,308,691.61	Po	Regjistri i PP-ve tregon emrat e pronarëve përfitues, shtetësinë, përqindjen e pronësisë, mënyrën e kontrollit, muajin dhe vitin e lindjes. Regjistri tregtar tregon edhe pronësinë ligjore direkte.
Shell Upstream Albania B.V (L21807009I)	Naftë dhe gaz	4,749,584.51	i pjesshëm	Regjistri i PP-ve tregon vetëm emrin e një prej përfaqësuesve ligjorë të huaj dhe shtatë pronarëve të tjerë ligjorë indirektë. Megjithatë, regjistri nuk tregon emrin, përqindjet e pronësisë, mënyrën e kontrollit dhe as se cili lloj subjekti ka pronësi ligjore indirekte. Regjistri nuk tregon nëse shoqëria është e listuar publikisht në

				bursën e ndonjë vendi tjetër, por për pronarët ligjorë jep emrin e subjektit tregtar (fusha 13-18).
Antea Cement Sh.a (K61914005R)	Minierat	3,609,251.77	Jo	Nuk gjendet në Regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit për Pronarët Përfitues. Regjistri tregtar tregon pronësinë ligjore direkte, që është një shoqëri e huaj.
Kaprolla & Kompani (L06817401D)	Minierat	520,717.55	Po	Regjistri i PP-ve tregon emrat e dy pronarëve përfitues, shtetësinë e tyre, përqindjen e pronësisë, mënyrën e kontrollit, muajin dhe vitin e lindjes. Regjistri tregtar tregon edhe pronësinë ligjore direkte.
Miniera e Kromit Katjel (K67812601U)	Minierat	201,481.07	Po	Regjistri i PP-ve tregon emrat e dy pronarëve përfitues, shtetësinë e tyre, përqindjen e pronësisë, mënyrën e kontrollit, muajin dhe vitin e lindjes. Regjistri tregtar tregon edhe pronësinë ligjore direkte.
11 Heronjte Bater (K28310906F)	Minierat	127,321.41	Po	Regjistri i PP-ve tregon emrat e dy pronarëve përfitues, shtetësinë e tyre, përqindjen e pronësisë, mënyrën e kontrollit, muajin dhe vitin e lindjes. Regjistri tregtar tregon edhe pronësinë ligjore direkte.
Ivno 1100 (K472204050)	Minierat	34,037.60	Po	Regjistri i PP-ve tregon emrin e pronarit përfitues, shtetësinë e tij/saj, përqindjen e pronësisë, mënyrën e kontrollit, muajin dhe vitin e lindjes. Regjistri tregtar tregon edhe pronësinë ligjore direkte.
Isaku (J96829402J)	Minierat	2,560.21	Po	Regjistri i PP-ve tregon emrin e pronarit përfitues, shtetësinë e tij/saj, përqindjen e pronësisë, mënyrën e kontrollit, muajin dhe vitin e lindjes. Regjistri tregtar tregon edhe pronësinë ligjore direkte.

Burimi: Kampioni përfshiu pesë taksapaguesit më të mëdhenj dhe pesë taksapagues të përzgjedhur krejt rastësisht nga lista e shoqërive në formularin e Transparencës, faqja “#4.1 - Subjektet raportuese”. Më 6 tetor 2021, për të marrë informacion në QKB rreth pronarëve përfitues kërkuam me NIPT-in e shoqërisë <https://qkb.gov.al/search/search-in-the-register-of-beneficial-owners-rbo/search-reporting-subject/> and <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

Shtojca B: Tabela e të ardhurave të Shqipërisë sipas Raportit të EITI-t 2017-2018

Publikimet e plota qeveritare dhe niveli i rakordimit
Raportuar nga qeveria

Sektori	Tema	Burimi	Lekë	Dollarë amerikanë (milionë)
Nafta dhe gazi	Agregati	Tabela 14	8,592,340,000.00	73.42
Nafta dhe gazi	Të tjera	Tabela 36	570,832,662.00	5.28
Minierat	Agregati	Tabela 23	18,363,300,000.00	170.02
Minierat	Të tjera	Tabela 36	278,145,905.00	2.58
Hidroenergjetika	Agregati	Tabela 28	15,920,700,000.00	147.40
Hidroenergjetika	Të tjera	Tabela 36	560,442,147.00	5.19
Të gjitha	Pagesa të tjera për NjQV-të**	Tabela 37	233,108,489.00	2.16
TOTALI			44,518,869,203.00	406.05

AGREGATET	42,876,340,000.00	390.84
------------------	--------------------------	---------------

* Llogatirur me kursin e këmbimit 1 dollar amerikan = 108.01 lekë shqiptarë

** Mbulon vetëm njësitë e qeverisjes vendore të përfshira në Validim: Bulqizë, Fier, Krujë, Lushnjë, Patos, Rroskovec.

Të ardhurat e rakorduara (tabela 46)

Sektori	Tema	Burimi	Lekë	Dollarë amerikanë (milionë)
Nafta dhe gazi	Shuma e përftuar	Tabela 46	7,435,021,000	68.84
Minierat	Shuma e përfituar	Tabela 46	3,788,674,000	35.08
Hydroenergjetika	Shuma e përfituar	Tabela 46	6,659,975,000	61.66
TOTALI			17,883,670,000	165.57
% e mbulimit të raportuar nga qeveria			40%	41%

* Llogatirur me kursin e këmbimit 1 dollar amerikan = 108.01 lekë shqiptarë

Pagesat ndaj NjQV-ve dhe niveli i rakordimit

Raportuar nga shoqëritë

Sektori	Tema	Burimi	Lekë	Dollarë amerikanë (milionë)
Minierat	Shoqëritë raportuese	Tabela 39	197,152,468.00	1.83
NG	Shoqëritë raportuese	Tabela 43	450,687,731.00	4.17
Hydroenergjetika	Shoqëritë raportuese	Tabela 41	41,364,275.00	0.38

TOTALI			689,204,474.00	6.38
---------------	--	--	-----------------------	-------------

* Logaritur me kursin e këmbimit 1 dollar amerikan = 108.01 lekë shqiptarë

Rakorduar

Sektori	Tema	Burimi	Lekë	Dollarë amerikanë (milionë)
Minierat	Shuma e përfituar	Tabela 54	97,840,000.00	0.91
NG	Shuma e përfituar	Tabela 50	129,176,000.00	1.20
Hydroenergjetika	Shuma e përfituar	Tabela 58	256,000.00	0.00
TOTALI			227,272,000.00	2.10
% e mbulimit të raportuar nga qeveria			33%	33%

* Logaritur me kursin e këmbimit 1 dollar amerikan = 108.01 lekë shqiptarë